



STUDIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE DHE JOFINANCIARE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NGA AUTORITETET LOKALE

Veles, 2019



This project is
funded by the
European Union



Здружение на финансиски работници

на општините самоуправи и јавните институции

Association of financial workers

of the local governments and public institutions



Европско движење Северна Македонија
European Movement North Macedonia





STUDIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE DHE JOFINANCIARE TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NGA AUTORITETET LOKALE

Veles, 2019



**STUDIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE DHE JOFINANCIARE
TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE NGA AUTORITETET LOKALE**

Botues:

Shoqata e punonjësve financiarë të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike – Veles

Rr. „8 Shtatori“ nr. 82-4, 1400 Veles,

Autorë:

Prof. dr Borçe Trenovski

Prof. dr Marina Serafimoska

Përktheu nga maqedonishtja:

M-r Manoil Bogdanovski

Lektura:

Prof.dr Agim Poljoska

Redaktor:

M-r Zoran Jankullovski

Tirazhi:

50 kopje

Dizajni, përgatitja teknike dhe shtypja:

Unistar Trejd – Veles

Ky botim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit "Organizatave të shoqërisë civile në shërbim të demokracisë lokale", financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit IPA për shoqëri civile dhe media dhe të zbatuar nga: Asociacioni Evropian për Demokraci Lokale (ALDA) Shkup, Shoqata e punonjësve financiarë të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike (SHPF) dhe Lëvizjes Evropiane (LE).

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së punonjësve financiarë të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike (SHPF), Asociacionit Evropian për Demokraci Lokale (ALDA)- Shkup dhe Lëvizjes Evropiane (LE) dhe jo gjithmonë i reflekton pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

CIP - Katalogimi i botimit

Biblioteka kombëtare dhe universitare

Studimi i mbështetjes financiare dhe jofinanciare të organizatave të shoqërisë civile nga autoritetet lokale/[autorë: Borçe Trenovski, Marina Trpeska]: Shoqata e punonjësve financiarë të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike – Veles, 2019 – 62 faqe;

Bibliografia: faqja 62

1. Trenovski Borçe

PËRMBAJTJA:

HYRJE.....	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	6
KORNIZA STRATEGJIKE, NORMATIVE DHE INSTITUCIONALE PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ORGANIZATAT QYTETARE.....	8
METODOLOGJIA E MBLEDHJES DHE E ANALIZËS SË TË DHËNAVE.....	10
ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT.....	12
1. Të dhëna të përgjithshme për organizatat e shoqërisë civile dhe fusha e veprimit.....	12
2. Shpërndarja e mbështetjes financiare për organizatat e shoqërisë civile	15
3. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në punën e NJVL-së.....	24
4. Bashkëpunimi i OSHC-ve me palët e interesuara/krijuesit e politikave.....	31
MJETET E BUXHETUARA KUNDREJT ATYRE TË PLANIFIKUARA TË KOMUNAVE TË DESTINUARA PËR MBËSHTETJEN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE.....	39
5. Shumat e buxhetuara dhe të realizuara sipas rajoneve të planifikimit për vitin 2017	39
5.1. Analizë krahasuese e shumave të buxhetuara dhe të realizuara sipas rajoneve të planifikimit për vitin 2017	44
6. Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara sipas komunave	44
7. Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara sipas rajonevetë veçanta të planifikimit dhe në nivel kombëtar 2013 – 2017	49
ANALIZË KUALITATIVE E INTERVISTAVE TË REALIZUARA.....	55
KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE	59
8. REKOMANDIME	61

HYRJE

Gjatë njëzet viteve të fundit, roli i organizatave të shoqërisë civile në procesin e zhvillimit të një shoqërie demokratike është rritur ndjeshëm. Termat "shoqëri civile" dhe "organizata të shoqërisë civile" (OSHC) edhe pse janë subjekt i shumë debateve, gjithsesi përdoren më së shumti për të përcaktuar dhe shpjeguar shoqërinë civile. Terma të tjerë që përdoren për definimin e sektorit të shoqërisë civile janë: organizata jofitimprurëse, OJQ-të (organizata joqeveritare), sektor i tretë, sektor vullnetar etj.¹ Qendra e Shoqërisë Civile në Universitetin John Hopkins (The Centre for Civil Society at John Hopkins University) i përcakton OSHC-të si: "Çdo organizatë, qoftë formale apo joformale, e cila nuk është pjesë e strukturave qeveritare, që nuk shpërndan fitime për organet e saj drejtuese, e cila është vetëqeverisëse dhe ku anëtarësimi është çështje e zgjedhjes së lirë, është organizatë civile"²

Sektori civil që me shpalljen e pavarësisë së shtetit në vitin 1991 e deri më sot ka pësuar ndryshime të rëndësishme në procesin e zhvillimit. Tranzicioni i shtetit nga socializmi në demokraci shënoi formë të reja të organizimit të qytetarëve në organizata joqeveritare. Në vitin 1990, në vend ishin regjistruar 4,203 organizata civile, por në vitin 2010, me miratimin e Ligjit të ri për shoqatat dhe fondacionet, u regjistruan 11,326 organizata. Në vitin 2010, me miratimin e Ligjit për shoqatat dhe fondacionet,³ u kushtëzuan të gjitha organizatat me procesin e ri-regjistrimit, me çka u zvogëlua në mënyrë të konsiderueshme numri i OSHC-ve të regjistruara. D.m.th., vetëm për një vit e gjysmë pas miratimit të ligjit, 4,650 organizata në vend kanë përfunduar procesin e ri-regjistrimit. Ky numër i organizatave të paregjistruara, d.m.th. Shoqata dhe fondacione, është një tregues i dukshëm që në territorin e të gjithë vendit ka shumë pak organizata aktive të shoqërisë civile ose organizata që janë të fuqishme në aspektin financiar, atë të personelit dhe nga ana operative, për të vazhduar punën e tyre. Për fat të keq, nuk ka informacion të saktë për numrin e regjistruar dhe numrin e OSHC-ve aktive.

Roli i OSHC-ve është të promovojë nivelin e demokracisë dhe cilësinë e jetës në nivel lokal dhe kombëtar. Suksesi i shoqërisë civile në arritjen e këtij misioni në masë të madhe varet nga mbështetja dhe partneriteti që marrin nga autoritetet lokale. Në këtë drejtim është realizimi i projektit "Organizatave qytetare në shërbim të demokracisë lokale", përmes të cilit synon të rrisë kontributin e sektorit civil në krijimin e politikave në nivel lokal. Përmes promovimit të bashkëpunimit të ndërsjellë midis të dy palëve, bëhet një përpjekje për të forcuar rolin e organizatave të shoqërisë civile veçanërisht në procesin e aderimit në BE. Tri palët kryesore të interesuara për t'u përfshirë në projekt janë: 1) organizatat e shoqërisë civile 2) komunat dhe 3) qendrat për zhvillim rajonal.

Si përparësi dhe dobësi të rëndësishme që identifikohen për sektorin civil përmenden:

¹Dorota I Pietrzyk, Civil Society – Conceptual History from Hobbes to Marx; Marie Curie Working Papers – No 1 (2001), Adran Gwleidyddiaeth Ryngwladol The Department of International Politics, Prifysgol Cymru Aberystwyth University of Wales Aberystwyth, 2001,

²Statement of the Sixteenth Annual Johns Hopkins International Fellows in Philanthropy Conference Nairobi, Kenya.

³Ligji për shoqata dhe fondacione, Gazeta zyrtare, nr. 52, e premte 16 prill 2010.

<http://www.slvessnik.com.mk/Issues/623772ADC92FEE42A1DB496E1E190648.pdf>

Tabela 1: Përparësitë dhe dobësitë e sektorit të shoqërisë civile

Avantazhet e sektorit të shoqërisë civile	Dobësitë e sektorit të shoqërisë civile -
Shoqëria civile kontribuon në aftësimin e qytetarëve.	Çrrënjësja e varfërisë ka një prioritet të ulët dhe aktivitetet janë ad hoc.
Shoqëria civile është më aktive në fushën e të drejtave të njeriut.	Aktivitet i pamjaftueshëm në lidhje me buxhetin kombëtar.
Shoqëria civile është më aktive në fushën e të drejtave të njeriut.	Pjesëmarrja e ulët e qytetarëve në shoqërinë civile
Shkallë e lartë e rrjetëzimit, komunikimit dhe bashkëpunimit midis organizatave të shoqërisë civile.	Organizatat nuk janë mjaft të përkushtuara ndaj marrëdhënieve të tyre me anëtarët, qytetarët dhe aktorët e tjerë.
Korrupsioni në shoqërinë civile është i rrallë.	Korrupsioni dhe "shoqëria civile e kapur" janë një shkak për frikë.
Shoqëria civile ka kapacitetin për të mbledhur mjete financiare nga burime të ndryshme.	Besimi i publikut është i ulët.
Mundësi më të mëdha për të ushtruar lirinë e shprehjes.	
Proceset e integritetit në Bashkimin Evropian (BE) ofrojnë një potencial pozitiv për ndryshim.	

Projekti përmban 5 paketa pune ku në kuadrin e paketës "Bërja e politikave dhe përfaqësimi", po zbatohet një studim i thellë i mbështetjes financiare dhe jofinanciare të pushtetit vendor për sektorin civil, së bashku me identifikimin e praktikave kryesore të bashkëpunimit midis dy palëve. Ky hulumtim duhet të japë një përgjigje për disa çështje kyçe si:

- Cilat janë praktikat më të zakonshme të mbështetjes së autoriteteve lokale ndaj organizatave të shoqërisë civile?
- A zhvillohet përkrahja financiare në mënyrë transparente?
- A janë prioritetet në përputhje me nevojat dhe interesat kryesore të qytetarëve?
- A është mbështetja financiare dominuese për veprim publik dhe përfitime të përgjithshme?

Përveç përgjigjes së pyetjeve të përmendura më lart, qëllimi kryesor i studimit është që në fund të arrihet në rekomandime të dobishme dhe të zbatueshme për zhvillimin e metodologjisë dhe transparencës për mbështetjen financiare dhe jofinanciare të autoriteteve lokale për organizatat e shoqërisë civile.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në këtë studim u përfshijnë të gjitha 81 komunat. Të dhënat u grumbulluan në disa mënyra, d.m.th përmes një pyetëso online të dërguar në të gjitha komunat, një kërkesë për qasje në informatat me karakter publik iu dorëzua të gjitha komunave dhe intervista të kryera në 30 komuna. Shkalla e përgjigjes së pyetjeve dhe kërkesave ishte pak mbi 50%, respektivisht 53%. Nga studimi i kryer mund të shihet se:

- ✓ Komunat kryesisht i financojnë organizatat e shoqërisë civile që kanë status ligjor të shoqatave qytetare dhe klubeve sportive. Për këtë arsye, aktivitetet që kryesisht financohen nga njësitë e pushtetit vendor janë artet dhe sportet, aktivitetet sociale, arsimi dhe edukimi, aktivitetet vullnetare dhe humanitare.
- ✓ Pothuajse 2/3 e komunave nuk i kanë përcaktuar fushat prioritare për shpërndarjen e fondeve. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, shumica e komunave në rajonin Jugperëndimor, nuk i kanë identifikuar fushat prioritare për mbështetje financiare.
- ✓ Pak më shumë se ½ e komunave shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve financiare të komunave. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, rajoni Jugperëndimor, ai i Shkupit dhe rajoni Juglindor janë me numrin më të madh të komunave që nuk shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve financiare në mbështetje të sektorit civil.
- ✓ Shpallja e thirrjeve publike zakonisht bëhet përmes faqes së internetit të komunës, portaleve lokale të internetit dhe stacioneve televizive dhe të radiove lokale.
- ✓ Një numër relativisht i madh ose pothuajse 2/3 e komunave deklaruan se posedojnë një strukturë të qartë për dorëzimin e një propozim projekti. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, kryesisht komunat e rajonit Jugperëndimor dhe të Pollogut nuk posedojnë një strukturë të zhvilluar për dorëzimin e projekt propozimeve.
- ✓ Shumica e komunave deklaruan se nuk kanë kritere të qarta për vlerësimin e projekt propozimeve dhe se ato ose sistemi i vlerësimit për projekt propozimet në shumicën e komunave nuk ishte shpallur publikisht.
- ✓ Gjysma e komunave ose pothuajse 50% e tyre deklaruan se ato e marrin vendimin për atë se cilat projektet do të mbështeten financiarisht nga komuna.
- ✓ Më shumë se gjysma e komunave të anketuara treguan qartë se nuk i shpallin publikisht projektet e mbështetura financiarisht nga komuna.
- ✓ Shumica e komunave, ose mbi 80%, tregojnë se kërkohet nga organizatat civile të dorëzojnë një raport mbi aktivitetet e projekteve të realizuara të cilat janë mbështetur financiarisht nga komuna.
- ✓ Pak më shumë se gjysma e komunave kanë raportuar se përgatisin raport vjetor për mjetet financiare të ndara për organizatat e shoqërisë civile dhe që monitorojnë realizimin e aktiviteteve të projektit. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, shumica e komunave në rajonin Jugperëndimor, të Pollogut dhe atij të Shkupit nuk kanë praktika të tilla.
- ✓ Më shumë se gjysma e komunave kanë deklaruar se nuk kanë një sektor të veçantë për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe se më së shpeshti komunat kanë një person të caktuar për këtë lloj bashkëpunimi që i përket një sektori tjetër, më së shpeshti në kuadër të sektorit ZHEL (Zhvillimi Ekonomik Lokal), sektorit juridik, sektorit të veprimtarive publike dhe sektorët e tjerë.
- ✓ Shumica ose mbi 80% e komunave mendojnë se projektet e zbatuara nga OSHC-të ofrojnë përfitime më të gjera për qytetarët dhe shoqërinë. Por, në të njëjtin numër, komunat deklaruan se nuk i matin efektet e projekteve të realizuara nga organizatat civile.
- ✓ Komunat mendojnë se mbështetja financiare e OSHC-ve është në përputhje me diapazonin dhe vëllimin, kurse organizatat e shoqërisë civile mendojnë se mbështetja financiare nuk është në nivelin e kërkuar, as nga madhësia as nga diapazoni.
- ✓ Shumica e komunave mendojnë se bashkëpunimi me OSHC-të ka avancuar në 5 vitet e fundit, kurse shumica e OSHC-ve konsiderojnë se një bashkëpunim i tillë nuk ka ndryshuar dukshëm në 5 vitet e fundit.
- ✓ Komunat deklaruan se për 5 vitet e fundit ata e kanë avancuar mbështetjen jofinanciare (in kind) të organizatave të shoqërisë civile. Megjithatë, një pjesë e tyre tregojnë se kjo lloj mbështetjeje rrallë

kërkohej prej tyre. Të njëjtin qëndrim e kanë edhe shumica e OSHC-ve, duke vënë në dukje se ata me të vërtetë e kërkojnë këtë lloj mbështetjeje më rrallë.

- ✓ Bashkëpunimi i komunave me sektorin civil në projekte që përkrahen financiarisht nga komunat është më i madh se ai i mbështetur nga një donator i huaj.
 - ✓ Bashkëpunimi në mes të komunave dhe organizatave të shoqërisë civile është më i madh në zbatimin e projekteve publike sesa në projekte për monitorimin dhe ndjekjen e politikave.
 - ✓ Është i përgjithshëm konstatimi se në të gjitha rajonet e planifikuara ekzistojnë komuna që kanë mospërputhje të mëdha ndërmjet fondeve të planifikuara dhe të realizuara për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile. Tek shumica e komunave, shuma e planifikuar është më e lartë se shuma e realizuar. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikuara, mospërputhje më të vogla ekzistojnë në rajonin e Shkupit, Pelagonisë dhe në rajonin Juglindor.
 - ✓ Kur shihen trendet në buxhetimin dhe realizimin e mjeteve financiare në komuna të caktuara, mund të vërehet se ka mospërputhje në dy drejtime, domethënë shuma e planifikuar është tejkaluar në raport me shumën e realizuar por dhe anasjelltas. Por ka edhe komuna që kanë dallime relativisht të vogla gjatë viteve në mjetet e buxhetuara dhe të zbatuara për mbështetjen e projekteve në sektorin civil.
 - ✓ Realizimi më i dobët i mjeteve të planifikuara për sektorin civil është vërejtur në rajonin Juglindor, Jugperëndimor, atë të Pellagonisë dhe të Pologut, kurse realizim i konsiderueshëm më i lartë nga buxhetet/planifikimet e mëhershme u vërejt në rajonin e Vardarit dhe atë Lindor.
- Devijime më të mëdha nga fondet e planifikuara për OSHC-të kemi në vitin 2016, kur realizimi është vetëm 62%, si dhe në vitin 2015, kur ne kemi realizim më të madh të mjeteve për sektorin civil me gati 20% nga ato të planifikuara. Në periudhën e mbetur çdo vit realizimi i mjeteve për OSHC-të ishte më i ulët në intervalin deri në 5% nga ato që ishin planifikuar.

KORNIZA STRATEGJIKE, NORMATIVE DHE INSTITUCIONALE PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR ORGANIZATAT QYTETARE

Sektori civil në vitet 1990 punonte sipas Ligjit për bashkimin e qytetarëve në shoqata, organizata shoqërore dhe organizata politike të themeluara në territorin e RSFJ-së (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 42/90) dhe Ligjit për Organizata dhe Shoqata shoqërore e qytetare (Gazeta Zyrtare e RSM Nr. 32/83 dhe 12/90). Më 25 qershor 1998, (Gazeta Zyrtare nr. 31/98), hyri në fuqi Ligji i ri për shoqatat qytetare dhe fondacionet. Procedura për regjistrimin e shoqatave dhe fondacioneve, në përputhje me këtë ligj, kryhet në Gjykatën Themelore, ku shoqata/fondacioni është i regjistruar në regjistrin e mbajtur nga gjykata themelore në territorin e së cilës është selia e tyre, ndërsa Gjykata Themelore Shkup I, mban një regjistër të vetëm të shoqatave qytetare dhe fondacioneve të regjistruara. Në vitin 2007, u bënë ndryshime në ligj, por vetëm në lidhje me procedurën për regjistrimin e organizatave me të cilat procesi i regjistrimit nga Gjykatat Themelore u transferua në Regjistrin Qendror. Ky ligj e rregullonte punën e OSHC-ve deri në vitin 2010 kur u miratua Ligji i ri për shoqata dhe fondacione (Gazeta Zyrtare nr. 52, datë 16.04.2010). Puna e OSHC-ve kushtëzohet edhe nga ligje të tjera: Ligji mbi kontabilitetin e organizatave jofitimprurëse⁴, i cili rregullon punën financiare të organizatave; Ligji mbi Lobimin⁵; Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe të ardhurave të tjera nga vepra penale dhe financimi i terrorizmit.⁶

Më tej, Ligji për shoqata dhe fondacione⁷ rregullon mënyrën, kushtet dhe procedurat për themelimin, regjistrimin dhe ndërprerjen e veprimtarisë së shoqatave, fondacioneve, aleancave, formave organizative të organizatave të huaja në vend, pronën që disponojnë, mbikëqyrjen, ndryshimet statusore dhe statusin e organizatave me interes publik. Sipas ligjit, "Organizatë" është çdo shoqatë, fondacion, aleancë si dhe çdo formë organizative e një organizate të huaj, si dhe format e tjera të shoqërimit, të regjistruara sipas dispozitave të këtij ligji.⁸

Regjistrimi i organizatave përcaktohet në nenet 40 deri 47. Regjistri qendror është institucioni i cili sipas këtij ligji është përgjegjës për procesin e regjistrimit dhe ri-regjistrimit të shoqatave dhe fondacioneve në vend. Mjetet për punën e shoqatave dhe fondacioneve sigurohen përmes donacioneve, tarifave të anëtarësisë, depozitave themeluese, dhuratave, legatave, të hyrave nga shërbimet që i arkëton organizata, të ardhurat nga investimet, dividendat, interesat dhe të ardhurat e tjera të parashikuara në statutin e organizatës, në përputhje me ligjet. Financimi i organizatave përcaktohet në nenet 48 deri në 55. Buxheti i institucioneve shtetërore dhe komunave, si dhe i Qytetit të Shkupit, në ligj citohen si burim i veçantë i financimit. Përgjegjësinë për dëmet që mund të lindin nga puna e organizatës e kanë të gjithë anëtarët, përveç rastit kur ndonjë anëtar në një protokoll të posaçëm distancohet nga puna e organizatës. Raportimi për punën e organizatës, sipas këtij ligji, është paraparë që secila organizatë, jo më vonë se 30 prilli, në mënyrë të përshtatshme t'i publikojë raportet financiare vjetore për vitin paraprak. Për mos përmbushjen e këtij detyrimi, vijnë gjoka për kundërvajtje. Ndërprerja dhe ndalimi i veprimtarisë së organizatës është përcaktuar në mënyrë të detajuar në nenet 63 deri në 72. Neni i fundit parashikon fshirjen e organizatës nga regjistri, me çka organizata pushon së ekzistuari si person juridik. Nenet 56 deri 58 e përcaktojnë mbikëqyrjen e punës së organizatës. Organi mbikëqyrës i organizatës është organ jo i detyrueshëm, kurse Ministria e Drejtësisë është e obliguar me këtë ligj të mbikëqyrë mbi dispozitat e këtij ligji. Me nenet 59 deri 62 përcaktohen ndryshimet e statusit të organizatës (bashkangjitja, bashkimi, ndarja e organizatës)⁹

Sipas raportit të Qendrës Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (QMBN) për zbatimin e Strategjisë për bashkëpunim të qeverisë me shoqërinë civile për periudhën Qershor 2012 - Dhjetor 2014: "Ligji i ri për shoqata dhe fondacione u miratua në vitin 2010 dhe që atëherë u imponua nevoja për monitorim të

⁴ Ligji për kontabilitet për organizata jofitimprurëse, Gazeta Zyrtare, nr. 24, viti 2003.

⁵ https://www.finance.gov.mk/files/u11/zakon_z_smetkovodstvo_za_neprofitni.pdf

⁶ Ligji për lobim, Gazeta Zyrtare, nr. 106 i datës 27.08.2008.

⁷ http://zeleni.org.mk/uploads/media/Zakon_za_Lobiranje.pdf

⁸ Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe të ardhurave të tjera nga vepra penale dhe financimi i terrorizmit, Gazeta Zyrtare, nr. 130/2014, 192/2015 dhe 27/2016, <http://ufr.gov.mk/files/docs/zakon.pdf>

⁹ Ligji për shoqata dhe fondacione, Gazeta Zyrtare, nr. 52, E premte 16 prill 2010.

¹⁰ <http://www.sivesnik.com.mk/Issues/623772ADC92FEE42A1DB496E1E190648.pdf>

¹¹ Decentralizimi fiskal për zhvillim më të mirë rajonal të shoqërisë civile, Qendra për Analiza Ekonomike - QAE, 2017.

¹² Ogdenovska, C. (2015) Dokument për politikë publike: Raporti mbi zbatimin e strategjisë për bashkëpunimin qeveritar me sektorin civil për periudhën qershor 2012 - dhjetor 2014

vazhdueshëm të ligjit, i cili në mënyrë më esenciale e pasqyron të drejtën për shoqërim të lirë. Megjithatë parashikohen në Strategji, ende nuk janë ndërmarrë aktivitete për monitorimin e zbatimit të LSHF, dhe as nuk është përgatitur analizë për përmirësimin e tij nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.¹⁰"

Si përparësi më të rëndësishme të Ligjit të ri për shoqata dhe fondacione mund të veçohen:

- 1) Ligji bën dallimin midis shoqatave dhe formave të tjera të shoqërimit, si partitë politike, sindikatat, dhomat/odat, etj.
- 2) Ligji ofron lehtësime tatimore dhe doganore për shoqatat dhe fondacionet.
- 3) Ligji përcakton parimet e funksionimit të shoqatave dhe organizatave (transparenca, publiciteti, joprofitabiliteti, pavarësia, veprimi jo partiak).
- 4) Ligji për herë të parë mundëson që themelues të shoqatave të jenë dhe persona juridikë, persona të huaj fizikë dhe juridikë si dhe të mitur.
- 5) Ligji përcakton një dispozitë jofitimprurëse. Kjo do të thotë që shoqatat dhe fondacionet në punën e tyre mund të përfitojnë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve ose përfitimeve të tjera, por aktiviteti duhet të jetë i lidhur ngushtë me misionin e organizatës, objektivat në statut dhe rezultatet që pritet të arrihen.
- 6) Ligji parashikon transferimin e kompetencave të organizatave, përkatësisht autorizimin publik të organizatave për kryerjen e kompetencave nga një organ i administratës shtetërore, vetëqeverisjes lokale ose organe të tjera që kanë autorizime publike.
- 7) Partneritet ndërmjet qeverisë dhe sektorit civil, si në nivel kombëtar ashtu dhe në atë lokal.

Si mangësi më të rëndësishme të Ligjit për shoqata dhe fondacione mund të veçohen:

- 1) Shumë akte nënligjore të nevojshme për zbatim konsekuent të ligjit nuk janë miratuar brenda afatit të caktuar.
- 2) Ndonëse ligji parashikon përjashtime tatimore dhe doganore, ende nuk është në përputhje me ligjet e tjera financiare në vend.

¹⁰Ogdenovska, C. (2015) Dokumentpërpolitikatpublike: Raporti mbi zbatimin e strategjisë për bashkëpunimin qeveritar me sektorin civil për periudhën qershor 2012 - dhjetor 2014

METODOLOGJIA E MBLEDHJES DHE E ANALIZËS SË TË DHËNAVE

Analiza e mbështetjes financiare dhe jofinanciare të organizatave të shoqërisë civile është bërë në bazë të mbledhjes dhe analizës së të dhënave primare dhe sekondare. Të dhënat primare janë ato që studiuesit vetë i kanë mbledhur direkt nga subjektet që i nënshtrohen hulumtimit. Në përgatitjen e këtij studimi kryesisht janë përdorur tri metoda të mbledhjes së të dhënave direkte:

- 1) Pyetësorë
- 2) Kërkesa për qasje në informacione me karakter publik dhe
- 3) Intervista.

Fillimisht u dërgua në mënyrë elektronike një pyetësor për të gjitha komunat (81), kurse reagime ndaj pyetësorit u morën nga 43 komuna nga 8 rajone ose shkalla e përgjigjes 53%. Mbledhja e të dhënave u realizua në periudhën 7 maj deri 15 qershor të vitit 2018. Komunat që u përfshinë në studim kanë karakteristika të ndryshme gjeografike, demografike dhe ekonomike. Nga gjithsej 43 komuna që u përfshinë në pyetësor, të ndara në 8 rajone të ndryshme planifikimi, rreth 10 prej tyre vijnë nga rajoni Jugperëndimor, ndërsa vetëm një komunë është e vendosur në rajonin Verilindor të republikës.

Rajoni Lindor përfaqësohet nga 8 komuna që marrin pjesë aktive në përgjigjen e pyetësorit, ndërsa rajonet e Vardarit dhe ai Juglindor përfaqësohen me 5 komuna. Rajoni i Pollogut përfaqësohet me 4 komuna, rajoni i Shkupit përfaqësohet me 7 komuna, ndërsa rajoni i Pellagonisë me 3 komuna. Pyetësori i tërë jepet në shtojcën në fund të studimit.

Pyetësori u dërgua në e-mail zyrtar të secilës komunë. Pjesa më e madhe e pyetjeve kishin për qëllim sigurimin e të dhënave për disa aspekte kryesore që lidhen kryesisht me metodologjinë e ndarjes së mjeteve për organizatat e shoqërisë civile, planifikimin e buxhetit dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile në planifikimin e buxhetit, transparencën si dhe identifikimin e formave të mbështetjes jofinanciare (in kind) që autoritetet lokale i praktikojnë kundrejt organizatave të shoqërisë civile.

Në kuadrin e mbledhjes së të dhënave primare, u realizuan 30 intervista. Gjysma e personave të intervistuar ose 15 intervista ishin me nga një përfaqësues nga komuna që ishte përgjegjës për organizatat e shoqërisë civile, ndërsa 15 intervistat e mbetura ishin me nga një përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile ose gjithsej 30 intervista. Intervistat u zhvilluan në periudhën prej 15 qershorit deri më 15 korrik 2018. Kohëzgjatja mesatare e intervistave ishte nga 45 minuta deri në 1 orë.

Përzgjedhja e komunave në të cilat u bënë intervista ishte në bazë të asaj se cilat komuna nuk i janë përgjigjur pyetësorit dhe kërkesës për qasje në informacionin publik, në mënyrë që të marrin më shumë informacion në lidhje me situatën në këto komuna, por dhe në komunat që kanë dukshëm rezultatet më të mira në mënyrë që të marrin informacion më të detajuar mbi praktikën e tyre të mira. Mbi këtë bazë u bënë intervistat në komunat e mëposhtme: Demir Kapi, Kavadar, Veles, Qendër, Gazi Babë, Radovish, Gjorçe Petrov, Kisella Vodë, Kumanovë, Makedonska Kamenica, Shtip, Çair, Shuto Orizarë, Sveti Nikollë dhe Haračinë.

Intervistat ishin të strukturuar, d.m.th. me të gjithë të intervistuarit bisedohej sipas një listë me pyetje të paracaktuara. Intervistuesi mbante shënime gjatë intervistës dhe menjëherë pas intervistës bëhej regjistrimi elektronik për secilin të anketuar në bazë të shënimeve. Temat kryesore që ishin pjesë e bisedave me të anketuarit ishin të lidhura me format e mbështetjes financiare dhe jo-financiare që komunat ua japin organizatave qytetare, si dhe transparenca në dhënien e ndihmës dhe mundësia e zhvillimit të një metodologjie për shpërndarjen e mjeteve për organizatat e shoqërisë civile. Përmbajtja e intervistave u analizuar nëpërmjet disa metodave: 1) Identifikimi i ngjashmëritë dhe dallimet në mes të të anketuarve 2) Identifikimi i përsëritjeve ose fjalë kryesore që përsëriten gjatë intervistave dhe 3) Identifikimi i varësive shkak-pasojë të theksuara nga të anketuarit.

Krahas të dhënave primare për kryerjen e analizës, u mbledhën të dhënat dytësore. Të dhënat dytësore u mbledhën duke kërkuar qasje në informacionin publik, në bazë të nenit 4 dhe nenit 12 të Ligjit për qasje të

lirë në informacione me karakter publik ("Gazeta zyrtare nr. 13/06, 86 / 08, nr. 6/10, 42/14, nr. 148/15 dhe nr. 55/16). Nëpërmjet një kërkesë u kërkuar të dhëna nga të gjitha organizatat, të cilave u janë dhënë fonde (për periudhën 2013-2017) në bazë të zërit 463 dhe nënzërit 489519 për të njëjtën periudhë, dhe mënyrën se si janë ndarë fondet e buxhetuara dhe vlera e planifikuar sipas pikave për të njëjtën periudhë. Krahas të dhënave të fituara nëpërmjet kërkesës për qasje në informata publike, një pjesë e të dhënave janë mbledhur përmes vizitave në faqet e internetit të komunave.

ANALIZA E REZULTATEVE TË STUDIMIT

Pjesa e parë e analizës së rezultateve të studimit i referohet të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit të anketës nga komunat. Pastaj janë paraqitur rezultatet e analizës cilësore të intervistave (të komunave dhe organizatave të shoqërisë civile), dhe në fund analizohen rezultatet e të dhënave të grumbulluara përmes kërkesës për qasje në informata publike.

1. Të dhëna të përgjithshme për organizatat e shoqërisë civile dhe fusha e veprimit

Analiza e të dhënave të mbledhura përmes pyetësorit është përshkruese në natyrën e saj dhe kryesisht ka për qëllim ta përshkruajë situatën në lidhje me mbështetjen financiare dhe jofinanciare të OSHC-ve nga komunat. Para së gjithash në tabelën nr. 2 jepet shpërndarja e komunave sipas rajoneve të planifikuara që janë të përfshira në analizë, pasi ata e plotësuan pyetësorin.

Tabela 2: Cilit rajoni të planifikimit i përkasin komunat?

Rajoni i planifikimit	Numri i komunave të përfshira në analizë	Pjesëmarja në përqindje e komunave të përfshira në analizë
Rajoni i Vardarit	5	12 %
Rajoni Lindor	8	19 %
Rajoni Jugperëndimor	10	23 %
Rajoni Juglindor	5	12 %
Rajoni i Pellagonisë	3	7 %
Rajoni i Pollogut	4	9 %
Rajoni Verilindor	1	2 %
Rajoni i Shkupit	7	16 %
Gjithsej	43	100 %


Nga 43 komunat që plotësuan pyetësorin, më të shumta janë komunat nga rajoni Jugperëndimor (numri total 10). Nga rajoni Lindor, pyetësori u plotësua nga 8 komuna, ndërsa pyetësori u plotësua nga 7 komuna nga rajoni i Shkupit. Rajoni i Vardarit dhe ai Juglindor janë të përfaqësuar me nga 5 komuna, ndërsa nga rajoni i Pollogut janë 4 komuna, kurse nga ai i Pellagonisë vetëm 3 komuna. Më së paku, ose vetëm një komunë e ka plotësuar pyetësorin nga rajoni i planifikimit Verilindor. Në kolonën e tretë të tabelës jepet përqindja e përfaqësimit të komunave në rajone të veçanta të planifikimit për të marrë një pasqyrë më të mirë të pjesëmarrjes së komunave të ndryshme në formular.

Me një përqindje prej 53% të përgjigjeve për pyetësorin (43 komuna) nga të gjitha rajonet e planifikimit, mund të thuhet se në përputhje me karakteristikat e rajoneve të veçanta, në këtë anketë përfshihen komuna të mjaftueshme si përfaqësuese të rajoneve të veçanta. Ky formular për nga madhësia dhe tërësia e tij është mjaft përfaqësues dhe indikativ në raport me temën e analizës së këtij studimi.

Analiza e përgjigjeve konfirmon se shumica dërrmuese e komunave, 40 nga 43 komuna ose 93% e komunave u ndajnë mjete financiare organizatave të shoqërisë civile. Ky raport tregon se në shumicën e komunave ekziston mbështetja financiare për organizatat e shoqërisë civile, që është sigurisht një nga

parakushtet më të rëndësishme që organizatat e shoqërisë civile ta përmbushin misionin e tyre në forcimin e proceseve demokratike në nivel lokal dhe qendror. Dy komuna që kanë raportuar se nuk kanë ndarë mjete për organizatat e shoqërisë civile vijnë nga rajoni Jugperëndimor, kurse një komunë që gjithashtu u përgjigj negativisht i përket rajonit të Shkupit. Në grafikun 1 tregohen rezultatet e përgjigjeve për pyetjen lidhur me dhënien e mjeteve financiare për OSHC-të.

Grafiku 1: A undan komuna mjete financiare OSHC-ve?



Përveç rëndësisë që të shohim se sa nga komunat u akordojnë në mënyrë aktive mjete financiare OSHC-ve, është gjithashtu shumë e rëndësishme të vërehet se si është shpërndarja e mjeteve për lloje të ndryshme të OSHC-ve nga aspekti i statusit të tyre ligjor.

**Tabela 3: Statusi ligjor i organizatave për të cilat janë ndarë mjete financiare
në periudhën 2013 - 2017.**

Statusi ligjor i organizatave	Numri i OSHC-ve
Shoqata qytetare	38
Klube sportive	33
Fondacione	6
Shoqëri kulturore-artistike	1
Iniciativa ose rrjeti joformal qytetar	4
Shoqata profesionale	2
Institut i kërkimeve	3
Parti politike	1

Nga rezultatet në tabelën 3 mund të vërehet se shumica e OSHC-ve që kanë marrë mjete financiare në periudhën e analizuar janë organizata me status ligjor Shoqata Qytetare dhe Klube Sportive. Më tej, mund të gjenden organizata që kanë status Fondacioni, Instituti të Kërkimeve, Shoqate Profesionale etj. Megjithatë, nga tabela 3 mund të konstatohet se kryesisht organizatat që kanë marrë fonde nga komunat kanë status ligjor si Klube Sportive ose si Shoqata Qytetare.

Zona gjeografike në të cilën OSHC-të veprojnë dhe në të njëjtën kohë marrin mbështetje financiare është një tregues shumë i mirë për të vlerësuar shtrirjen e këtyre organizatave për veprim aktiv. Sipas rezultateve nga tabela 4, mund të shihet se shumica e OSHC-ve (33 gjithsej) veprojnë në nivel lokal ose komunal. Menjëherë pas tyre me diçka më pak (nga 10 organizata) janë organizatat qytetare që veprojnë në nivel qyteti, komuniteti lokal dhe atij kombëtar. Rezultatet në një farë mase janë të pritshme, sepse është mjaft e justifikuar që autoritetet lokale në mënyrë dominuese t'i mbështesin financiarisht ato organizata qytetare që kryesisht veprojnë në nivel lokal dhe mbrojnë kryesisht interesat e qytetarëve nga komuna apo komuniteti lokal. Megjithatë, mund të thuhet se në një farë mase komunat sigurojnë mbështetje financiare për

organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel kombëtar, por edhe rajonal dhe ndërkombëtar. Organizata të tilla që kanë një aktivitet të këtillë dhe janë përfituese të mjeteve financiare, kryesisht i përkasin rajonit të Shkupit dhe atij Jugperëndimor.

Tabela 4: Zona gjeografike e veprimit të organizatave për të cilat janë ndarë mjete në periudhën 2013-2017.

Zona gjeografike	Numri
Në nivel ndërkombëtar (në BE dhe/ose më gjerë)	2
Rajonale (në Ballkan)	3
Kombëtare	10
Rajoni i planifikimit	6
Qytet	10
Lokale/komunale	33
Komuniteti lokal	10

Më poshtë, në tabelën nr. 5, tregohet pjesëmarrja e OSHC-ve të veçanta sipas llojit të aktiviteteve që ata kryejnë dhe kështu kanë marrë mbështetje financiare nga komunat. Mund të vërehet lehtësisht se numri më i madh i organizatave (30 gjithsej) janë nga fusha e arteve dhe sporteve, para së gjithash, shoqatat kulturore artistike që veprojnë në kuadër të komunave dhe klubet sportive që konkurrojnë në nivel komunal dhe rajonal.

Tabela 5: Kategoria e aktivitetit të organizatave për të cilat janë ndarë fondet për periudhën 2013-2017

Kategoria e aktiviteteve të organizatës	Numri
Aktivitete për të forcuar komunikimin	5
Aktivitete vullnetare/humanitare	13
Art dhe sport	30
Aktivitete sociale	15
Ngritja e vetëdijes qytetare	11
Edukimi dhe arsimimi	15
Mbrojtja nga zjarri	1
Avancimi i kapaciteteve njerëzore	4
Manifestime kulturore	1
Aktivizmi qytetar	14
Aktivitetet kërkimore	7
Zhvillimi socio-ekonomik	6

Pjesa më e madhe e mbështetjes financiare që ndahet nga buxheti komunal për OSHC-të shkon për këtë lloj aktiviteteve. Rezultatet nga tabela nr. 4 janë në përputhje me rezultatet e tabelës 2, që në pajtim me statusin ligjor të organizatave të shoqërisë civile që kanë marrë mbështetje financiare, dominojnë organizatat sportive, kulturore dhe artistike. Megjithatë, si kategori e dytë më e rëndësishme janë ato organizata qytetare që kryejnë aktivitete sociale, aktivitete vullnetare/humanitare dhe aktivizëm qytetar. Nëse i analizojmë prioritetet e komunave, mund të thuhet se sporti është një prioritet më i rëndësishëm, para aktiviteteve sociale dhe humanitare, por edhe para arsimit dhe edukimit. Si plotësim i tabelës 5, tabela 6 i kategorizon OSHC-të sipas sektorëve të veprimit. Nga rezultatet në tabelën 6 mund të vërehet se shumica e organizatave që kanë marrë mjete financiare i përkasin sektorit të kulturës, fëmijëve, të rinjve, dhe studentëve dhe personave me aftësi të kufizuara. Rezultatet tregojnë se janë të pakta në numër organizatat që kanë marrë fonde nga komunat dhe veprojnë në sektorët e arsimit, shkencës dhe hulumtimit, shëndetësisë dhe kujdesit shëndetësor, të moshuarve, të drejtave të njeriut dhe sektorit të informacionit, komunikimit dhe medias. Në kategorinë të mbetura klasifikohet aktivitete si: migrimi,

qeverisja e mirë, marrëdhëniet ndëretnike, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimi evropian, agro-sektori, mbrojtja e konsumatorit, zhvillimi i shoqërisë civile.


Tabela 6: Sektorët e veprimit të organizatave të cilave u janë ndarë mjete financiare për periudhën 2013-2017

Sektorët e veprimit të organizatave	Numri
Fëmijë, të rinj dhe studentë	29
Mjedisi dhe burimet natyrore	11
Kulturë	31
Personat me aftësi të kufizuara	20
Gratë dhe probleme gjinore	12
Informacion, komunikim dhe media	2
Arsimit, shkenca dhe hulumtimi	9
Shëndeti dhe kujdesi shëndetësor	6
Persona të moshuar	8
Të drejtat e njeriut	3
Të mbetura	7

2. Shpërndarja e mbështetjes financiare për organizatat e shoqërisë civile

Analiza e përgjigjeve të marra nga komunat nga aspekti i praktikës së tyre për të përcaktuar fushat prioritare për ndarjen e mjeteve për OSHC-të tregon se më shumë se gjysma e komunave nuk kanë përcaktuar fushat e tyre prioritare për ndarjen e mjeteve për organizatat qytetare. Grafiku nr. 2 paraqet të dhënat kumulative të komunave të grupuara sipas rajoneve të planifikimit, me qëllim që të merret një ide për analizën krahasuese ndërmjet rajoneve të veçanta të planifikimit.

Grafiku 2: A i ka identifikuar komuna fushat prioritare për dhënien e mjeteve për OSHC-të?




Nëse i shohim rezultatet e grafikut, mund të vërehet se pothuajse dy të tretat e komunave (29 ose 67.44%) nuk i kanë identifikuar fushat prioritare për shpërndarjen e mjeteve, ndërsa vetëm një e treta (14 ose 32.66%) kanë deklaruar se i kanë përcaktuar të njëjtat prioritete. Për më tepër, në nivel të rajoneve të veçanta, mund të konstatohet se në rajonin Jugperëndimor, 8 komuna nuk i kanë identifikuar fushat prioritare për ndarjen e mjeteve, kurse vetëm dy komuna kanë përcaktuar fushat e tyre prioritare. Nga ana tjetër, 6 komuna që ndodhen në rajonin Lindor janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje dhe vetëm 2 komuna reagojnë negativisht nga i njëjti rajon. Megjithatë, si konkluzioni më i thjeshtë që mund të rrjedhë nga grafiku nr. 3 është se ka një numër të madh (2/3) të numrit të përgjithshëm të komunave që janë

deklaruar negativisht, që do të thotë se komunat duhet të rrisin kapacitetet e tyre për planifikim më të suksesshëm dhe shpenzime më efikase të fondeve buxhetore në lidhje me organizatat joqeveritare.

Grafiku nr. 3 është vazhdim i pyetjes së mëparshme lidhur me identifikimin e fushave prioritare për financimin e OSHC-ve nga ana e komunave të veçanta dhe paraqet përgjigjet e komunave në lidhje me atë nëse prioritetet e vendosura tani janë në përputhje me nevojat e qytetarëve. Rezultatet janë paraqitur sipas rajoneve të ndryshme të planifikimit.


Grafiku 3: A janë prioritetet e përcaktuara në përputhje me nevojat e qytetarëve?



Gjithsej 26 komuna (ose 60% e komunave nga të cilat janë siguruar pyetësorë të kompletuar) i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes, d.m.th. se prioritetet e përcaktuara janë në përputhje me nevojat e qytetarëve. 17 komunat e mbetura (ose 40%) i janë përgjigjur pyetjes negativisht. Nëse i shikojmë rezultatet në zona të caktuara mund të vërejmë se të gjashtë komunat në rajonin e Vardarit dhe i njëjti numër në rajonin e Lindjes janë përgjigjur pozitivisht, kurse 7 komuna në rajonin Jugperëndimor janë përgjigjur negativisht në pyetjen e kërkuar. Numri më i madh i komunave që janë përgjigjur negativisht në pyetjen e kërkuar, gjithsej shtatë, janë në rajonin Jugperëndimor.


Grafiku nr. 4 tregon rezultatet e pyetjes nëse komunat shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve për organizatat e shoqërisë civile. Grafiku tregon se pak më shumë se gjysma e komunave ose 56% shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve financiare për OSHC-të. Kjo tregon se është i madh numri i komunave që nuk ndajnë fonde për OSHC-të në bazë të konkurrencës së hapur të një thirrjeje publike. Kjo, nga ana tjetër, hedh dyshime në se organizata më e mirë qytetare, sa i përket kapacitetit për të realizuar, përvojës dhe ekspertizës së mëparshme, i ka marrë mjetet financiare, kur ato nuk janë marrë në një thirrje publike.

Grafiku 4: Shpallja e thirrjeve publike për dhënien e mjeteve për organizatat e shoqërisë civile



Në grafikun nr. 5 tregohet shpërndarjen e komunave sipas rajoneve të veçanta të planifikimit në përputhje me praktikën e dhënies së mjeteve përmes një thirrjeje të hapur publike.


Grafiku 5: Shpallja e thirrjes publike për dhënien e mjeteve për OSHC-të sipas rajoneve të planifikuara



Informacioni i marrë tregon se rezultatet janë më të dobëta në rajonin Jugperëndimor dhe rajonin e Pollogut, me mbi 70% të komunave që kanë deklaruar se nuk shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve.

Grafiku nr. 6 tregon mënyrat në të cilat shpallen thirrjet publike për dhënien e mjeteve. Në grafik mund të vërehet se shumica e komunave (45%) i shpallin thirrjet në faqen e tyre të internetit. Më tej, 19% u përgjigjën se thirrjet publike shpallen në portalet lokale të internetit, ndërsa vetëm 15% përdorin kanalet lokale të radios dhe televizionit si kanale për shpalljen e thirrjeve.


Grafiku 6: Mënyra e shpalljes së thirrjeve publike për dhënien e mjeteve për OSHC-të



Shumë më rallë, komunat i dërgojnë thirrjet publike nëpërmjet mesazheve elektronike (7%), 4% ishin informuar pas paraqitjes së kërkesës me dokumentacion të përshtatshëm, 2% i pranorin me postë dhe 8%

e komunave deklaruan se nuk shpallin fare thirrje publike. Grafiku nr. 7i paraqet në mënyrë figurative kanalet për shpalljen e thirrjeve publike sipas rajoneve të planifikimit.


Grafiku 7: Mënyra e shpalljes së thirrjeve publike sipas rajoneve të planifikimit



Është e lehtë të vërehet se vetëm komunat e rajonit të Pellagonisë dhe të rajonit Juglindor (100%) përdorin faqen e tyre të internetit për shpalljen e thirrjeve publike. Të gjitha rajonet e tjera në një masë të konsiderueshme e përdorin faqen e tyre të internetit për të publikuar thirrjet, dhe në një masë të madhe portalet lokale të internetit. Prandaj, mund të konkludohet se faqet e internetit të komunave dhe portalet lokale të internetit paraqiten si mënyrat më të zakonshme të shpalljes së thirrjeve publike. Vetëm në rajonin Jugperëndimor të planifikimit, 44% e komunave deklaruan se fare nuk kishin shpallur asnjë thirrje publik për dhënien e mjeteve për sektorin qytetar/civil.


Përgjigjet e marra për pyetjen se a ekziston një strukturë e përcaktuar qartë për paraqitjen e projekt propozimeve nga ana e sektorit civil tregojnë se një numër relativisht i madh i komunave ose 63% kanë raportuar që posedojnë një strukturë ose model të qartë për dorëzimin e projekt propozimeve. Sidoqoftë, ende është i konsiderueshëm numri i komunave (37%), të cilat kanë reaguar negativisht për këtë çështje (Grafiku nr. 8).

Grafiku 8: Ekzistenca e strukturës për dorëzimin e propozimit të projektit



Grafiku nr. 9më poshtë tregon shpërndarjen e përgjigjeve të komunave në lidhje me ekzistencën e një strukture për paraqitjen e projekteve për çdo rajon planifikimi.


Grafiku 9: Ekzistenca e strukturës për dorëzimin e propozim projektit sipas rajoneve të planifikimit



Kur analizohet struktura rajonale e përgjigjeve të dhëna, vihet re se komunat nga katër rajonet e planifikimit (të Vardarit, Juglindor, Verilindor dhe të Shkupit) i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes. Vetëm komunat në rajonin Jugperëndimor janë përgjigjur negativisht (100%) në pyetjen e shtruar, por është i madh dhe numri i komunave (mbi 70%) nga rajoni i Pollogut që gjithashtu janë përgjigjur negativisht në pyetjen e shtruar. Kjo do të thotë se komunat e rajonit Jugperëndimor dhe atij të Pollogut mbeten në mënyrë të konsiderueshme prapa bashkive nga rajonet e tjera në formalizimin e procesit të dhënies së mjeteve për organizatat e shoqërisë civile.

Grafiku nr. 10na jep informacion në lidhje me praktikën eventuale të komunave për të shpallur publikisht sistemin e vlerësimit në bazë të të cilit vlerësohen projektet propozimet. Përmes përgjigjeve në këtë pyetje bëhet përpjekje për të kuptuar nivelin e transparencës që e sigurojnë komunat për mënyrën se si bëhet vlerësimi i projekteve.

Grafiku 10: A është shpallur publikisht sistemi i pikëve për vlerësim të projekteve?




Nga rezultatet mund të konstatohet se me përjashtim të rajonit Verilindor, ku e vetmja komunë që i është përgjigjur pyetësorit e ka shpallur sistemin e pikëve për vlerësimin e projekteve, në të gjitha rajonet e tjera ka komuna të cilat nuk e kanë shpallur publikisht sistemin e pikëve për vlerësimin e projekteve. Kështu për shembull, në rajonin Jugperëndimor, një rajon me numrin më të madh të komunave që i janë përgjigjur pyetësorit, nga 10 komuna, vetëm njëra e ka shpallur sistemin e pikëve për vlerësimin e projekteve, në rajonin i Lindor nga tetë komuna, vetëm 3 kanë shpallur sistemin për rangim, kurse në rajonin e Pollogut

asnjë nga katër komunat nuk e ka shpallur sistemin e pikëve për vlerësimin e proekteve. Nga këtu është e lehtë të konkludohet se niveli i transparencës nga pikëpamja e sistemit të pikëve për vlerësimin e projekt propozimeve në shumicën e komunave është i ulët dhe është i nevojshëm përmirësimi i tij.

Krahas informacionit mbi transparencën e kritereve të vlerësimit të projekteve, është shumë e rëndësishme të dihet nëse komunat në përgjithësi kanë kritere të tilla. Prandaj, në grafikun nr. 11, janë treguar përgjigjet e komunave pikërisht për këtë çështje.


Grafiku 11: A ekzistojnë kritere për mënyrën e vlerësimit të projekteve?



Rezultatet tregojnë se shumica e komunave janë përgjigjur negativisht. Kjo do të thotë që komunat nuk i publikojnë kriteret për vlerësimin e projekteve të paraqitura, sepse shumica e tyre në përgjithësi as që i kanë definuar ato. Komunat në të cilat ekzistojnë kritere për vlerësimin e projekteve kryesisht vijnë nga rajoni Lindor, rajoni Juglindor, rajoni i Pellagonisë dhe rajoni Verilindor.

Në grafikun nr. 12 tregohen rezultatet sipas rajoneve të planifikimit në lidhje me nevojën e komunave për të krijuar një komision për vlerësimin e projekteve të paraqitura.

Grafiku 12: A është paraparë që të krijohet një komision për vlerësimin e projekteve?




Shumica e komunave në rajonin Lindor dhe Verilindor kanë përcaktuar formalisht një obligim për të krijuar një komision për vlerësimin e projektit. Nga 8 komunat e rajonit Lindor, 6 prej tyre u përgjigjën pozitivisht për këtë çështje. Komuna e Nagoricanit të Vjetër, e cila është e vetmja komunë e mbuluar në formular nga rajoni Verilindor, gjithashtu është përgjigjur pozitivisht për këtë çështje. Nga ana tjetër, në rajonin

Jugperëndimor, deri në 90% e komunave, domethënë 9 në vlerë absolute nga gjithsej 10 komuna nuk kanë përcaktuar formalisht një nevojë për krijimin e një komisioni për vlerësimin e projekteve. Në rajonin e Shkupit, edhe pse kjo përqindje është më e ulët, përsëri përqindja prej 57% është ende e lartë. Në rajonin e Pollogut, pjesëmarrja e tillë është 75%, d.m.th. 3 nga 4 komunat që vijnë nga rajoni i Pollogut janë përgjigjur se nuk kanë një nevojë formale të përcaktuar për krijimin e një komisioni për vlerësimin e projekteve të paraqitura.

Rezultatet e përgjigjeve të komunave në bazë të transparencës që komunat ua sigurojnë OSHC-ve për punën e komisionit që vlerëson projektet e paraqitura janë prezantuar në grafikun nr. 13.

Grafiku 13: A është puna e komisionit publike dhe e hapur për të gjitha palët e interesuara?




Në komunat ku është caktuar formimi i një komisioni të tillë, shumica janë përgjigjur se puna e komisionit është publike dhe është në dispozicion për të gjitha palët e interesuara. Vetëm në rajonin Lindor dhe Juglindor një pjesë e komunave ku është caktuar ky lloj i komisionit janë përgjigjur se puna e komisionit nuk është publike dhe nuk është e hapur për të gjitha palët e interesuara. Ky konstatim të çon në përfundimin se ekziston një nivel i caktuar i transparencës dhe përfshirjes së të gjitha palëve të interesuara, të cilat janë drejtpërdrejt të prekura nga aktivitetet në punën e komunave.

Grafiku nr. 14na jep rezultate në lidhje me vendin e vendimmarrjes për atë se cili nga projektet do të mbështetet financiarisht? Përgjigjet e kësaj pyetjeje duhet të sigurojnë një pamje nëse komunat janë ato që i sjellin vendimet e financimit të projekteve që mbështeten me mjete buxhetore të komunës.


Nga gjithsej 43 komuna që përfshihen në këtë anketë, 21 komuna i janë përgjigjur negativisht kësaj pyetjeje, ndërsa 22 komuna janë përgjigjur se ato marrin vendim për të zgjedhur projektin që do të financohet. Nga 8 komuna në rajonin Lindor, 6 komuna kanë deklaruar se komunat marrin vendim për përzgjedhjen e projektit që do të financohet. Nga ana tjetër, në rajonin Jugperëndimor, nga 10 komuna, 8 janë përgjigjur negativisht për këtë çështje, kurse vetëm 2 komuna kanë konfirmuar se ato marrin vendim për përzgjedhjen e projektit që do të financohet.

Grafiku 14: A merr vendim komuna për të zgjedhur një projekt që do të financohet?



Grafiku nr. 15na jep një pasqyrë të përgjigjeve në lidhje me pyetjen për shpallje publike për projektet e përzgjedhura nga komuna. Nga gjithsej 43 komuna që janë subjekt i shqyrtimit në këtë studim, 23 komuna përgjigjen negativisht për këtë çështje, që do të thotë se ata nuk e praktikojnë shpalljen publike të projekteve të përzgjedhura. Nga ana tjetër, 20 komuna janë përgjigjur pozitivisht se kanë informacione në dispozicion të publikut për projektet që janë përzgjedhur.


Grafiku 15: A i shpall komuna publikisht projektet e përzgjedhura?



Nëse i shikojmë përgjigjet sipas rajonevetë ndryshme të planifikimit, komunat që vijnë nga rajoni Lindor në një numër të madh (75%) e praktikojnë shpalljen publike të projekteve të përzgjedhura. Në rajonin Jugperëndimor, situata është krejt e kundërt, ku 90% e komunave nuk i shpallin publikisht informacionet për projektet që janë mbështetur financiarisht nga buxheti i komunës.

Në grafikun nr. 16 tregohen rezultatet në lidhje me obligimet që i kanë komunat në bazë të raportimit për projektet e realizuara nga mjetet buxhetore të komunave.


Grafiku 16: A duhet që OSHC-të të cilat shfrytëzojnë mjete nga komunat të dorëzojnë një raport mbi përdorimin e mjeteve?



Nga gjithsej 43 komuna të përfshirane pyetësor, deri 81% ose në vlerë absolute 35 komuna u përgjigjën se kërkojnë prej OSHC-ve të dorëzojnë një raport mbi shfrytëzimin e mjeteve të ndara nga komunat. Në komunat që vijnë nga rajoni i Vardarit, 100% e komunave janë përgjigjur se OSHC-të kanë detyrimin të paraqesin një raport mbi përdorimin e mjeteve. I njëjti numër (prej 100%) mund të vërehet edhe në komunat që vijnë nga rajoni i Pollogut. Në rajonin Lindor 87.5% e komunave i obligojnë organizatat për të raportuar mbi përdorimin e mjeteve, kurse në rajonin Jugperëndimor kjo përqindje është 60%, e cila gjithashtu përfaqëson pjesëmarje më të ulët në krahasim me komunat e tjera të analizuara nga rajone të ndryshme. Sa i përket komunave që vijnë nga rajoni i Shkupit, 6 prej 7 komunave të anketuara janë përgjigjur se organizatat e shoqërisë civile kanë obligim që të raportojnë mbi përdorimin e mjeteve. Nga rezultatet mund të konkludohet se është relativisht i lartë numri i komunave që kërkojnë nga organizatat e shoqërisë civile të raportojnë për mjetet e përdorura, të ndara nga komuna për të financuar aktivitetet e projektit.

Në grafikun nr. 17 janë prezantuar përgjigjet e komunave lidhur me monitorimin që ata bëjnë për realizimin e projekteve nga ana e OSHC-ve.


Figura 17: A kryen komuna monitorim të realizimit të projekteve të cilat i ka financuar?



Krahas kësaj, 25 nga 43 komuna (58.13%) pohuan pozitivisht për këtë çështje, duke vënë në dukje se po monitorojnë organizatat e shoqërisë civile në zbatimin e projekteve. 18 komunat e tjera, ose 41.87%, i janë përgjigjur negativisht të njëjtës pyetje. Numri më i madh i komunave që monitorojnë projektet e zbatuara nga shoqëria civile janë komunat nga rajoni i Shkupit, ku 85% e komunave kryen monitorimin e zbatimit të projekteve, kurse nga ana tjetër, me një përqindje të lartë (70%) të përgjigjeve negative, janë komunat e rajonit Jugperëndimor, të cilat janë përgjigjur se nuk kanë bërë monitorim mbi realizimin e projekteve që ato i financuan.

Në grafikun nr.18 tregohen rezultatet për ekzistencën e praktikës së komunave për të përgatitur një raport vjetor mbi mbështetjen financiare që u është dhënë OSHC-ve.

Grafiku 18: A përgatit komuna një raport vjetor mbi mbështetjen e realizuar për organizatat e shoqërisë civile?




Konkretisht, nga numri i përgjithshëm i komunave të anketuara, 55% kanë raportuar që nuk dorëzojnë një raport vjetor mbi mbështetjen e realizuar të organizatave të shoqërisë civile, ndërsa vetëm 19 komuna, ose 45%, përgatisin një raport të tillë. Kur i analizojmë të dhënat për rajonet e veçanta të planifikimit, mund të vihet re se në rajonin Lindor gjysma e komunave të anketuara (ose 50%) i janë përgjigjur pozitivisht pyetjes së shtruar. Në rajonin Jugperëndimor prej gjithsej 10 komunave, vetëm 2 komuna e përgatisin këtë lloj raporti, 8 komunat e mbetura janë përgjigjur se nuk përgatisin raport mbi mbështetjen e realizuar të organizatave të shoqërisë civile.

3. Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile në punën e NJVL-së


Grafiku nr. 19 jep rezultatet e marra nga studimi i komunave nëse ato kanë një njësi të veçantë organizative, detyra e së cilës është të bashkëpunojë me organizatat e shoqërisë civile. Nga grafiku mund të vërehet se në 25 komuna nuk ka njësi të veçantë organizative që është përgjegjëse për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile. Vetëm në 18 komuna ka një njësi të tillë organizative. Nëse i analizojmë të dhënat sipas rajoneve të veçanta të planifikimit, mund të konkludojmë se në komunat që i përkasin rajonit të Shkupit, 6 nga 7 komuna kanë një njësi të tillë organizative. Nga ana tjetër, në rajonin Juglindor nga gjithsej 5 komuna, vetëm një komunë deklaroi se brenda strukturës së saj organizative ka një njësi organizative përgjegjëse për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Në rajonin Jugperëndimor prej 10 komunave, 8 komuna (ose 80%) u përgjigjën se nuk kanë formuar një organizatë të veçantë përgjegjëse për këtë punë.

Grafiku 19: A ka komuna një njësi organizative e cila është përgjegjëse për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile?



Grafiku nr. 20 jep rezultatet e përgjigjeve të komunave në lidhje me praninë ose mungesën e një personi në komunë, posaçërisht përgjegjës për bashkëpunimin me sektorin civil. Në një farë mënyre ky është vazhdim logjik i pyetjes së mëparshme, me qëllim që të shihet se në rastet kur komunat nuk kanë një njësi të veçantë organizative, të paktën të mund të kenë një person përgjegjës për bashkëpunim me sektorin civil.

Grafiku 20: Nëse nuk ekziston në njësi organizative, a ka një person përgjegjës për bashkëpunim dhe komunikim me OSHC-të?




Mund të thuhet se në shumicën e komunave ku nuk ka njësi të veçantë për bashkëpunim me sektorin civil, ka një person të veçantë përgjegjës për këto aktivitete. Në grafikun nr.20 tregohet se shumica e komunave në rajonin e Pollogut kanë një person të angazhuar në komunë, i cili duhet t'i kryejë këto aktivitete. Numri më i vogël i komunave që kanë një person që është përgjegjës për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile është në rajonin Jugperëndimor. Sipas rezultateve të treguara në grafik, vetëm 18 prej komunave të anketuara pozitivisht iu përgjigjën pyetjes në lidhje me ekzistencën e një personi për kontakt

dhe bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, kurse 25 prej komunave konstatuan se nuk ka asnjë person përgjegjës për këtë detyrë.

Grafiku nr. 21 i paraqet rezultatet e përgjigjeve të komunave lidhur me identifikimin e qartë të njësisë organizative përgjegjëse për bashkëpunimin me sektorin civil.


Grafiku 21: Nëse ka, cila njësi organizative është përgjegjëse për bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile?



Rezultatet tregojnë se në komunat ku ekziston një njësi organizative përgjegjëse për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, ajo më së shpeshti është në kuadër të sektorit ZHEL (Zhvillimi Ekonomik Lokal), sektorit për aktivitete publike dhe sektorëve të tjerë (si për shembull: sektori i arsimit, sportit, kulturës dhe mbrojtjes, sektori për mbrojtje sociale, shëndetësore, të fëmijëve dhe mbrojtje të tjera). Sipas rezultateve të anketës, kjo njësi organizative në 8 raste është në kuadër të sektorit ZHEL (Zhvillimi Ekonomik Lokal), në 7 raste ajo është në kuadër të sektorit publik, ndërsa në 4 raste është në kuadër të sektorëve të tjerë.

Grafiku nr. 22 paraqet rezultatet e sondazhit lidhur me përfshirjen aktive të organizatave të shoqërisë civile në përgatitjen e asaj pjese të buxhetit komunal, që është e destinuar pikërisht për mbështetjen e sektorit civil.

Grafiku 22: A janë përfshirë OSHC-të në përgatitjen e buxhetit komunal në pjesën për mbështetjen e tyre?




Sa i përket rezultateve në pjesën ku përshkruhet niveli i përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në përgatitjen e buxhetit komunal, ato jepen në grafikun nr. 23. Në grafik mund të shihet se përfshirja më e madhe e organizatave të shoqërisë civile në përgatitjen e buxhetit është në rajonin Lindor, rajonin Juglindor, përkatësisht në rajonin e Shkupit. Vetëm komunat që ndodhen në rajonin Jugperëndimor në

përgjithësi kanë më pak përfshirje të organizatave të shoqërisë civile. Nga gjithsej 10 komuna në këtë rajon, 7 prej tyre u përgjigjën se OSHC-të nuk janë të përfshira në përgatitjen e buxhetit, në pjesën që i referohet mbështetjes së organizatave të shoqërisë civile. Kurse vetëm 3 komuna në këtë rajon i kanë përfshirë OSHC-të në përgatitjen e buxhetit.

Në grafikun nr. 23 tregohen rezultatet lidhur me fazën, gjegjësisht pjesën në të cilën OSHC-të më së shumti janë të përfshira në mënyrë aktive nga komunat kur krijojnë buxhetin për mbështetjen e sektorit civil. Nëse ne shikojmë rezultatet në formë të përmbledhur mund të vërehet se 70% e komunave i përfshijnë organizatat e shoqërisë civile në fazën e planifikimit të buxhetit dhe në përgatitjen dhe prezantimin e projekt buxhetit, gjegjësisht 30% e komunave janë përgjigjur qartë që nuk i përfshijnë organizatat e shoqërisë civile në përgatitjen e buxhetit.


Grafiku 23: Në cilën fazë të procesit të buxhetimit janë përfshirë organizatat e shoqërisë civile?



Nëse i shohim rezultatet sipas rajoneve të caktuara të planifikimit, mund të vërehet se 75% e komunave të vendosura në rajonin Lindor i përfshijnë organizatat e shoqërisë civile në përgatitjen e buxheteve, dhe këtë e bëjnë në fazën e planifikimit, përgatitjes dhe prezantimit të projektbuxhetit. Në kuadër të rajonit Juglindor, ku janë përfshirë gjithsej 5 komuna, 4 nga komunat janë përgjigjur qartë se ato i përfshijnë organizatat e shoqërisë civile në përgatitjen e buxhetit për financimin e sektorit civil. Në përgjithësi, nga 43 komuna që janë subjekt i analizës në këtë anketë, 27 (ose 62.79%) komuna kanë deklaruar se ka një farë shkalle të përfshirjes së OSHC-ve në përgatitjen e buxhetit të komunës në faza të veçanta, ndërsa 16 komuna (ose 37.21 %) iu përgjigj negativisht kësaj pyetje. Pothuajse 2/3 e komunave janë përgjigjur se ekziston një nivel i caktuar i përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në përgatitjen e buxhetit për financimin e sektorit civil.

Në grafikun nr. 24 tregohen rezultatet e anketimit të komunave për hapjen dhe vullnetin e tyre për të pranuar propozime për financim të ofruara nga organizatat e shoqërisë civile. Niveli i gatishmërisë dhe hapjes së komunave për të pranuar propozimet e paraqitura nga sektori civil është shprehur në përqindje si më poshtë: nën 50%, që do të thotë se pranohen më pak se gjysma e propozimeve të ofruara, nga 51-80% e propozimeve të ofruara janë pranuar dhe 81% - 100% e propozimeve të ofruara janë pranuar.


Grafiku 24: Deri në ç'masë janë miratuar propozimet e OSHC-ve pjesë e buxhetit final?



Nga gjithsej 7 komuna në rajonin e Shkupit, dy komuna karakterizohen nga një shkallë e miratimit të propozimeve nga organizatat e shoqërisë civile në nivelin 81-100%. Një shkallë e tillë e miratimit të propozimeve mund të shihet dhe në rajonin Lindor, ku nga tetë komuna gjithsej, vetëm një komunë shprehu gatishmëri të lartë për të pranuar propozime nga sektori civil. Duhet të theksohet se rreth 65% e komunave të analizuar sipas nivelit të miratimit të propozimeve të OSHC-ve bëjnë pjesë në një nivel të ulët të pranimit, ose 50% e më pak. Vetëm 12% e komunave i përkasin kategorisë së dytë, në nivel mesatar të gatishmërisë (51% - 81%) për pranimin e propozimeve nga ana e komunave. Shumë pak ose vetëm 3% e komunave janë në nivelin më të lartë të hapjes dhe të gatishmërisë për të pranuar propozimet e financimit që ofrohen nga sektori civil.

Në grafikun nr. 25 tregohen përgjigjet e komunave në lidhje me mendimin e tyre mbi përfitimet e mundshme për shoqërinë të cilat i ofrojnë projektet e zbatuara nga organizatat e shoqërisë civile.

Grafiku 25: A përfiton shoqëria nga politikat e projekteve të zbatuara ose në përgjithësi nga rezultatet dhe jetet e dhuruara?




Shumica e komunave të anketuara, ose 84%, u përgjigjën se projektet e zbatuara në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, të financuara nga fondet e komunës, janë në funksion të rritjes së

përfitimeve të shoqërisë. Vetëm një numër më i vogël komunash ose 16% e komunave iu përgjigjën negativisht kësaj pyetjeje. Nëse e shohim atë, mund të vërehet se numri më i madh i komunave që janë përgjigjur negativisht janë nga rajoni Jugperëndimor, ku nga 10 komuna, 3 komuna janë përgjigjur negativisht. Të gjitha komunat që i përkasin rajonit të Vardarit, të Pollogut dhe atij Juglindor janë përgjigjur pozitivisht duke përlogaritur se projekte të tilla janë në funksion të rritjes së përfitimeve për qytetarët.

Në grafikun nr. 26 paraqiten rezultatet që i japin përgjigjet e komunave lidhur me pjesëmarrjen e tyre në matjen e efekteve të mundshme nga realizimi i projekteve të organizatave të shoqërisë civile të financuara me mjete buxhetore të komunës. Përgjigjet për këtë pyetje janë shumë të rëndësishme sidomos për një monitorim më të mirë të realizimit të projekteve, si dhe për përcaktim më të mirë të efikasitetit të projekteve dhe kontrollimin e optimizimit të fondeve publike të shpenzuara. Më pak se gjysma (ose 46%) e komunave u përgjigjën se matin efektet e projekteve që realizohen nga organizatat e shoqërisë civile dhe financohen nga mjetet buxhetore të komunës.

Grafiku26: A i mat komuna efektet e projekteve të realizuara apo të parave të shpenzuara?



Nëse analizohen rezultatet sipas rajoneve të veçanta të planifikimit mund të vërehet se komunat që kryesisht vijnë nga rajoni Jugperëndimor, ai i Pollogut dhe rajoni Verilindor në mënyrë dominuese nuk kryejnë matje të efekteve të projekteve të tilla të realizuara. Nga gjithsej 10 komuna në rajonin Jugperëndimor, 7 komuna nuk kryejnë asnjë matje të efekteve të projekteve të realizuara, ndërsa në rajonin e Pollogut 3 nga 4 komuna thanë se nuk i masin efektet e projekteve në të cilat ata kanë një pjesë të konsiderueshme në financim.


Më poshtë, në grafikun nr. 27 paraqiten përgjigjet e komunave lidhur me mendimin e tyre nëse mbështetja financiare që vjen nga komunat është në përputhje me nevojat e organizatave të shoqërisë civile.

Analiza tregon se 32% e komunave të anketuara mendojnë se financimi aktual i OSHC-ve nuk është i mjaftueshëm dhe se duhet të rritet; 31% u përgjigjën se financimi korrespondon vetëm për nga diapazoni, por shumica e mjeteve nuk është e mjaftueshme për të përmbushur nevojat e organizatave të shoqërisë civile; 24% u përgjigjën se financimi korrespondon si nga vlera ashtu edhe nga diapazoni; dhe vetëm 13% e komunave të anketuara janë përgjigjur se financimi nuk korrespondon as nga vlera, as nga diapazoni për përmbushjen e nevojave të OSHC-ve.


Nëse përgjigjet për të njëjtën pyetje analizohen sipas rajoneve të veçanta të planifikimit, mund të vërehet se vetëm komunat në rajonin Verilindor 100% janë përgjigjur se fondet e ndara për organizatat e shoqërisë civile korrespondojnë si nga vlera ashtu edhe nga diapazoni. Komunat e pjesës më të madhe të rajoneve të planifikimit më shpesh konsiderojnë se mjetet financiare kryesisht përshtaten në aspektin e diapazonit,

por ato janë të pamjaftueshme sa i përket vlerës së mjeteve të përdorura për të financuar aktivitetet e projektit brenda atij diapazoni. Prandaj, jo rrallë komunat janë përgjigjur se financimi për aktivitetet e projekteve të OSHC-ve duhet të rritet.

Grafiku27: A korespondon financimi i komunave me nevojat e OSHC-ve?



Grafiku 28: Korrespondimi i financimit të komunave me nevojat e OSHC-ve sipas rajoneve planifikuese




Për shembull, 2/3 (ose 66.7%) e komunave të anketuara në rajonin planifikues të Shkupit dhe 2/3 (ose 66.7%) e komunave të anketuara në rajonin planifikues të Pellagonisë u përgjigjën se financimi i organizatave të shoqërisë civile duhet të rritet.

4. Bashkëpunimi i OSHC-ve me palët e interesuara/krijuesit e politikave

Këtë pjesë të analizës e fillojmë duke prezantuar rezultatet në lidhje me arsyet për ndarjen e mjeteve financiare për organizatat e shoqërisë civile. Nëse shohim rezultatet e përgjithshme në nivel shtetëror, duke i përmbledhur rajonet e veçanta të planifikuara, mund të vërehet se shumica e komunave (30%) i ndajnë fondet për përmirësimin e shërbimeve të qytetarëve në nivel lokal.


Grafiku 29: Arsyet për ndarjen e mjeteve për OSHC-të



Tri arsyet të tjera, si sigurimi i mbështetjes për sektorin civil, mbështetja e një projekti të një aktiviteti të caktuar ose përmirësimi i imazhit të komunës, janë motivues relativisht të barabartë për ndarjen e mjeteve nga komunat për sektorin civil.


Nëse në grafikun nr. 30 shohim shpërndarjen e përgjigjeve të komunave të anketuara sipas rajoneve të veçanta të planifikimit, mund të konkludojmë lehtësisht se të tetë rajonet e planifikimit veçmas, me një përqindje të lartë, janë përgjigjur se "përmirësimi i shërbimeve në nivel lokal të destinuar për qytetarët" është arsyeja kryesore për dhënien e fondeve. Një numër shumë i vogël i komunave ose 5.6% e komunave në rajonin e Shkupit deklaruan se asnjë fond nuk u shpërndahet organizatave të shoqërisë civile.

Grafiku 30: Arsyet për ndarjen e mjeteve për OSHC-të sipas rajoneve të planifikimit



Në grafikun nr. 31 tregohen rezultatet e matjes së perceptimit të komunave lidhur me ndjenjën e tyre të brendshme nëse komunat në 5 vitet e fundit mendojnë se është intensifikuar bashkëpunimi i tyre me organizatat e shoqërisë civile.


Grafiku 31: Niveli i rritur i bashkëpunimit me OSHC-të përmes mbështetjes financiare në pesë vitet e fundit



Sa i përket pretendimit se "Në pesë vitet e fundit komuna ka rritur nivelin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile përmes mbështetjes financiare", 39% e organizatave janë përgjigjur se përgjithësisht pajtohen, 35% janë dakord dhe 5% e komunave të anketuara kanë deklaruar se nuk pajtohen aspak. Mund të konkludojmë se rreth 80% e komunave të anketuara janë shprehur qartë se në pesë vitet e fundit komuna e ka rritur nivelin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet dhënies së mbështetjes financiare.

Në grafikun nr. 32 tregohen rezultatet e shkallës së bashkëpunimit të komunave me organizatat e shoqërisë civile, në formën e mbështetjes jofinanciare ("in kind"). Mund të vërejmë se 40% e komunave janë përgjigjur se e kanë përmirësuar bashkëpunimin e tyre me organizatat e shoqërisë civile duke ofruar mbështetje jofinanciare. Dakordim të pjesshëm shprehën rreth 33%, kështu që shifra totale prej 73% është relativisht e lartë në aspektin e perceptimit të komunave për procesin e intensifikimit të bashkëpunimit "in kind" për 5 vitet e fundit.

Grafiku 32: Rritja e nivelit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet mbështetjes jofinanciare ("in kind") në pesë vitet e fundit




Megjithatë, një numër më i vogël i komunave, ose 21% (duke i përfshirë përgjigjet "nuk pajtohem" dhe "nuk pajtohem aspak") janë përgjigjur negativisht në lidhje me këtë pyetje të pyetësorit. Kjo sugjeron që 1/5 e

komunave nuk kanë përmirësuar bashkëpunimin “in kind” me organizatat e shoqërisë civile në 5 vitet e fundit.

Nëpërmjet pyetësorit u vlerësuan dhe forma të tjera të bashkëpunimit në mes të komunave dhe organizatave të shoqërisë civile. Për shembull, në grafikun 33 tregohen rezultatet e anketës mbi perceptimin e komunave, nëse është intensifikuar bashkëpunimi në formën e përfshirjes së organizatave të shoqërisë civile në punën e komunës në 5 vitet e fundit.


Grafiku 33: Rritja e nivelit të bashkëpunimit me OSHC-të përmes përfshirjes më të madhe në punën e komunës në pesë vitet e fundit



Nëse i mbledhim komunat të cilat pjesërisht ose plotësisht janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen e shtruar, mund të konkludojmë se rreth 86% e komunave konsiderojnë se ky lloj bashkëpunimi është intensifikuar në 5 vitet e fundit. Vetëm 14 përqind e komunave të anketuara janë përgjigjur se ato plotësisht ose pjesërisht nuk janë dakord me pretendimin se bashkëpunimi midis dy palëve është rritur përmes përfshirjes në punën e tyre.

Në grafikun nr. 34 tregohen rezultatet e shqyrtimit të perceptimit të komunave për nivelin e bashkëpunimit që ka ekzistuar për vitet e fundit në fushën e sjelljes së politikave lokale. Më shumë se $\frac{1}{2}$ ose 58% e komunave u përgjigjën se janë dakord se në 5 vitet e fundit ka pasur një nivel në rritje të bashkëpunimit me OJQ-të në fushën e sjelljes së politikave lokale. Nëse kësaj i shtohen edhe ato komuna që kanë shprehur pajtueshmëri të pjesshme (25% e komunave të anketuara) numri i përgjithshëm prej 83% i komunave konsiderojnë se ky lloj bashkëpunimi është intensifikuar në 5 vitet e fundit.


Grafiku 34: Rritja e nivelit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile nëpërmjet konsultimeve për miratimin e politikave lokale në pesë vitet e fundit



Vetëm një pjesë e vogël ose më pak se 1/5 e komunave (ose 17%) konsiderojnë se ky lloj i bashkëpunimit të ndërsjellë me organizatat e shoqërisë civile nuk ka përparuar në 5 vitet e fundit.

Në vijim, në grafikun nr. 35 janë paraqitur rezultatet e studimit të perceptimit të komunave lidhur me besimin e tyre nëse bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile në fushën e avancimit të shërbimeve publike ka përparuar gjatë 5 viteve të fundit.


Grafiku 35: Rritja e nivelit të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile për përmirësimin e shërbimeve publike në pesë vitet e fundit



Rreth 3/4 (ose 74%) e komunave shprehën një qëndrim tërësisht ose pjesërisht pozitiv, duke rënë dakord që bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile në fushën e përmirësimit të shërbimeve publike në 5 vitet e fundit ka përparuar dukshëm. Pjesa e mbetur, ose 23% e komunave u përgjigj se ky lloj bashkëpunimi nuk ka avancuar në 5 vitet e fundit.

Në grafikun nr. 36 paraqiten rezultatet e vlerësimit të nivelit të bashkëpunimit të komunave me organizatat qytetare në projekte të përbashkëta të mbështetura financiarisht nga komunat.


Grafiku 36: Bashkëpunimi me OSHC-të për projekte të përbashkëta të financuara nga komunat



Nga rezultatet e paraqitura në grafikun 36 mund të shihet se mbi 2/3 (ose 67%) e komunave të anketuara janë përgjigjur pozitivisht se kanë bashkëpunim me organizatat qytetare në projekte të përbashkëta të

mbështetura financiarisht nga komunat. Përgjigjet për të njëjtën pyetje, të shpërndara nëpër rajonet e planifikimit janë paraqitur më poshtë në grafikun nr. 37.


Grafiku 37: Bashkëpunimi me OSHC-të për projekte të përbashkëta të financuara nga komunat sipas strukturës rajonale



Të gjitha komunat (100%) nga të tri rajonet, atij të Pollogut, të Pellagonisë dhe rajonit Verilindor reagues pozitivisht në pyetjen nëse komunat kanë një lloj të tillë bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile. Komunat e të dy rajoneve, atij Jugperëndimor me 90% dhe të Vardarit me 40% kanë përqindjen më të lartë të reagimit negativ për këtë pyetje lidhur me bashkëpunimin në projekte të përbashkëta me organizatat e shoqërisë civile.

Grafiku nr. 38i jep përgjigjet e komunave për nivelin e bashkëpunimit që ata kanë në projektet e përbashkëta, por këtë herë për projekte të financuara nga një donator i huaj. Grafiku 39i jep të njëjtat përgjigje në lidhje me bashkëpunimin e komunave me organizatat civile për projekte të financuara nga një donator i huaj, por sipas rajoneve të ndryshme të planifikimit.


Grafiku 38: Bashkëpunimi me OSHC-të për projekte të përbashkëta të financuara nga një donator i huaj



Vetëm 47% e komunave janë përgjigjur pozitivisht se kanë bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile për projekte të financuara nga donatorë të huaj. Ky numër është dukshëm më i ulët kur e krahasojmë bashkëpunimin që komunat e kanë me organizatat e shoqërisë civile për projektet e financuara nga

vetëqeverisja lokale. Nëse i shikojmë rezultatet në disa rajone të veçanta të planifikuara, ne mund të shohim se rajoni Verilindor me 100%, rajoni Juglindor me 80% dhe rajonin i Pollogut me rreth 75% janë rajone në të cilat komunat kanë pasur më shumë bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile për projekte të financuara nga donatorë të huaj.


Grafiku 39: Bashkëpunimi me OSHC-të për projekte të përbashkëta të financuara nga një donator i huaj sipas strukturës rajonale



Komunat e rajonit Jugperëndimor me 90%, rajonit të Vardarit me 60% dhe atij të Pellagonisë me rreth 65% janë përgjigjur se nuk kanë bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile për projekte të përbashkëta të financuara nga një donator i përbashkët.

Në grafikun 40 tregohen përgjigjet e komunave në lidhje me llojet e tjera të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe shërbimeve. Në të njëjtin grafik tregohen rezultatet në formë të përmbledhur për të gjitha komunat pa ndarje sipas rajoneve të planifikimit.


Grafiku 40: Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe shërbimeve



Nga rezultatet e paraqitura mund të vërehet se rreth 1/3 e komunave ose 35% e komunave të anketuara janë përgjigjur pozitivisht, duke treguar se komunat e kanë këtë lloj bashkëpunimi. Kjo do të thotë se afër 2/3 ose 65% e komunave të përfshira në formularin e këtij studimi kanë deklaruar se nuk e praktikojnë këtë lloj bashkëpunimi në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave.

Në grafikun nr. 41, të njëjtat rezultate, të përmbledhura për këtë lloj bashkëpunimi, tregohen sipas rajoneve të veçanta të planifikimit. Nga grafiku është e lehtë të vërehet se në këtë lloj bashkëpunimi, kryesojnë komunat që vijnë nga rajoni i Pellagonisë me 65%, ai Juglindor me 60% si dhe rajoni i Pollogut dhe ai Lindor me 50%.


Grafiku 41: Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe shërbimeve



Komunat nga rajone e mbetura si ai i Shkupit, i Vardarit dhe rajoni Jugperëndimor kryesisht (mbi 50%) janë përgjigjur se shpesh kanë mungesë bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave dhe shërbimeve.


Grafiku nr. 42 na tregon rezultatet e nivelit të bashkëpunimit të komunave me organizatat civile në fushën e ndjekjes, përkatësisht zbatimit të aktiviteteve të projektit.

Grafiku 42: Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile për ndjekjen dhe zbatimin e projekteve publike



Një shumicë e madhe e komunave ose 70% e tyre, në formular u përgjigjën pozitivisht se kanë praktikë për të bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile në lidhje me ndjekjen dhe zbatimin e projekteve. Në grafikun nr. 43 mund të shihen të njëjtat rezultate të paraqitura sipas rajoneve të veçanta të planifikimit.

Grafiku 43: Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile për ndjekjen dhe zbatimin e projekteve publike sipas rajoneve të planifikimit



Komunat nga pothuajse të gjitha rajonet e planifikimit kanë deklaruar qartë se kanë bashkëpunim të konsiderueshëm me organizatat e shoqërisë civile në pjesën e zbatimit të projekteve publike. Vetëm komunat që vijnë nga rajoni Jugperëndimor i planifikimit, me një përqindje të lartë (80%) janë përgjigjur se nuk e praktikojnë një lloj të tillë bashkëpunimi.


MJETET E BUXHETUARA KUNDREJT ATYRE TË PLANIFIKUARA TË KOMUNAVE TË DESTINUARA PËR MBËSHTETJEN E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

5. Shumat e buxhetuara dhe të realizuara sipas rajoneve të planifikimit për vitin 2017

Në kuadër të këtij seksioni paraqiten rezultatet sipas rajoneve të ndryshme të planifikimit nga aspekti i marrëdhënies që ekziston në mes të vlerave të buxhetuara dhe aktiviteteve të realizuara të projektit për vitin 2017. Nëpërmjet krahasimit të shumave të planifikuara, gjegjësisht të buxhetuara dhe shpenzimeve aktuale të realizuara për të mbështetur organizatat e shoqërisë civile mund të merrni pamje më të mirë për nivelin aktual të mbështetjes që ekziston nga qeveria lokale kundrejt shoqërisë civile. Të dhënat për analizën janë mbledhur nga burimet sekondare (nga komunat) në përputhje me mundësinë e parashikuar nga ligji për qasje në informacione me karakter publik.

Në grafikun nr. 44 jepet një pasqyrë e shumave të buxhetuara dhe të realizuara nga komunat e veçanta në rajonin e Shkupit për vitin 2017. Duhet të theksohet se nga komunat e prezantuara, Komuna e Aerodromit ka vlerën më të lartë të buxhetuar dhe të realizuar për vitin 2017. Për vitin 2017, shuma e buxhetuar është 20,956,630 denarë, ndërsa shuma e realizuar për vitin 2017 është 16,956,630 denarë ose në vlerë relative prej 83,6%. Komuna e dytë në radhë nga rajoni i Shkupit është ajo e Çairit, ku mund të vërehet se shuma e buxhetuar është 16,150,000 denarë, ndërsa vlera e realizuar është 9,322,000 denarë. Në vlerë relative, ky raport i realizimit është 57.7%.

Grafiku 44: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave në rajonin e planifikuar të Shkupit për vitin 2017




Më tej, Komuna Gjorçe Petrov për vitin 2017 ka buxhetuar shumën prej 2.750.000 denarë, ndërsa shuma e realizuar është 1,452,300 denarë, gjegjësisht në raport relativ realizim-planifikim në vlerë rreth 53%. Nëse e shikoni Komunën Gazi Babë për vitin 2017 mund të konstatooni se shumat e saj të buxhetuara dhe të realizuara, në vlerë absolute janë shumë më të ulëta se komunat e tjera, por shkalla e realizimit është mjaft e lartë. Gjegjësisht, në vitin 2017 Komuna e Gazi Babës ka buxhetuar shumën prej 648 mijë denarë, dhe përqindja e realizimit është 100%, përkatësisht 648,000 denarë janë realizuar në periudhën e analizuar.

Është gjithashtu shumë interesante të analizohen shumat e komunës Ilinden si një nga komunat që ka parë një rritje të agregatëve ekonomikë gjatë viteve të fundit. Komuna e Ilindenit për vitin 2017 ka një vlerë të

buxhetuar prej 1.530.000 denarë, ndërsa vlera e realizuar arrin në 331.000 denarë. Në raport relativ, kjo shumë e realizuar në aspektin e shumave të buxhetuara është 22% për periudhën e analizuar.

Grafiku nr. 45na jep një pasqyrë të shumave të buxhetuara dhe të realizuara të komunave të rajonit të Vardarit. Brenda këtij rajoni, ishin të disponueshme të dhënat për tri komunat e përfshira në studim: Llozovë, Sveti Nikollë dhe Gradsko. Nëse shikoni në Komunën e Sveti Nikollës, mund të vërehet se shuma e buxhetuar për vitin 2017 është 1,730,000 denarë, ndërsa shuma e realizuar për vitin 2017 është 1,440,000 denarë. Raporti relativ i buxhetimit dhe realizimit në këtë komunë është 83%.


Grafiku 45: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave në rajonin e Vardarit për vitin 2017



Për dy komunat e mbetura ne nuk kemi siguruar qasje në të dhënat e nevojshme. Pra, për Komunën e Llozovës, ne i prezantojmë të dhënat vetëm në pjesën për shumën e realizuar prej 287,500 denarësh, ndërsa për Komunën Gradsko ne nuk kemi fare të dhëna.

Në grafikun nr. 46tregohen shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave nga rajoni Jugperëndimor për vitin 2017. Brenda këtij rajoni janë paraqitur të dhënat për komunat: Debarcë, Kërçovë, Makedonski Brod, Ohër dhe Strugë, ndërsa Komuna e Vevçanit nuk disponon një informacion të tillë.

Grafiku 46: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave në rajonin Jugperëndimor për vitin 2017




Nga grafiku mund të vërehet se Komuna e Kërçovës ka vlerën më të lartë të realizuar për vitin 2017 prej 7,695,000 denarësh, ndërsa për të njëjtin vit nuk disponon një shumë të buxhetuar. Më tej, Komuna e

Debarcës ka një shumë të buxhetuar prej 1.550.000 denarësh në pjesën e shumës së buxhetuar, ndërsa vlera e realizuar është 765.000 denarë ose në një raport relativ prej 49%. Komuna e vetme në rajonin Jugperëndimor që ka një vlerë më të lartë të realizuar nga ajo e buxhetuar është Komuna e Ohrit. Komuna e Ohrit ka buxhetuar një vlerë prej 1,100,000 denarësh, kurse ka realizuar një vlerë prej 1,226,855 denarësh. Komuna e Strugës ka një vlerë identike të buxhetuar dhe të realizuar prej 830.180 denarësh. Për Komunën e Vevçanit, siç kemi përmendur më parë, ne nuk siguroam qasje në informacionin e nevojshëm.

Raportet e mjeteve të buxhetuara dhe të realizuara të komunave të rajonit Verilindor janë treguar më poshtë në grafikun me numër rendor 47. Nga të dhënat e grafikut mund të vërehet se shumica më e madhe e vlerës së buxhetuar është në Komunën e Kriva Pallankës në vlerë prej 1.600.000 denarësh, kurse nga ana tjetër vlera e përgjithshme e realizuar është 95,000 denarë, e cila në vlerë relative arrin 5,9%.


Grafiku 47: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave në rajonin Verilindor për vitin 2017



Komuna e Kumanovës ka një shumë të buxhetuar prej 1.500.000 denarësh, ndërsa vlera e realizuar është 1.150.000 denarë. Për komunat Rankovcë dhe Nagorican i Vjetër, informacioni është i disponueshëm vetëm për shumën e buxhetuara, përkatësisht 150.000 denarë dhe 200.000 denarë.

Grafiku nr. 48i tregon shumën e buxhetuara dhe të realizuara të komunave nga rajoni i Pellagonisë për vitin 2017 nga zëri 463 dhe nënzëri 489519.


Grafiku 48: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave nga rajoni i Pellagonisë për vitin 2017



Rajoni i Pellagonisë përfshin nëntë komuna, por në studim paraqiten të dhëna vetëm për katër komuna, duke përfshirë Demir Hisarin, Krivogashtanin, Resnjën dhe Krushevën. Në mesin e katër komunave të lartpërmendura, komuna Resnjë veçohet nga njëra anë me shumën maksimale të planifikuara dhe të realizuara, dhe në anën tjetër Komuna e Krushevës, e cila nuk ka mjete të planifikuara dhe të realizuara për organizatat e shoqërisë civile për vitin 2017. Komuna e Resnjës për vitin 2017 ka buxhetuar 1,150,000 denarë, nga të cilat 769,000 denarë janë mjete të realizuar ose 66,86% realizim të mjeteve të planifikuara. Pastaj vjen Komuna e Krivogashtanit me buxhetim prej 580,000 denarësh dhe realizim prej 79.000 denarësh, duke u karakterizuar me një shkallë të ulët të realizimit të mjeteve të buxhetuara prej 13.62%. Komuna e Demir Hisarit, megjithëse ka mjete të ulëta të planifikuara dhe të realizuara me vlerë prej 200,000 denarësh dhe 149,000 denarësh, karakterizohet nga një shkallë relativisht e lartë realizimi prej 74.5%.

Në grafikun nr.49 janë paraqitur mjetet totale të planifikuara dhe të realizuara të komunave për të gjitha organizatat e shoqërisë civile në vitin 2017 për të gjithë zërat nga komunat që i përkasin rajonit Lindor. Rajoni Lindor përfshin njëmbëdhjetë komuna, por sipas qasjes në informata brenda këtij studimi, përfshihen vetëm shtatë komuna, midis të cilave Vinica, Delçeva, Zërnovci, Karbinci, Koçani, Pehçeva dhe Probishtipi.


Grafiku 49: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave në rajonin Lindor të planifikimit për 2017



Nga grafiku mund të vërehet se Komuna e Vinicës ka planifikuar 3.400.000 denarë dhe ka realizuar 3.350.998 denarë duke pasur një shkallë realizimi prej 98.6%. Gjithashtu, Komuna e Dellçevës ka një shkallë të lartë të realizimit të fondeve të buxhetuara prej 87.6%. Komuna e Zërnovcit ka planifikuar 40,000 denarë dhe ka realizuar 134,000 denarë dhe ka një shkallë shumë të lartë realizimi nga ajo që ishte planifikuar me 335%. Komuna e Karbincit ka planifikuar mjete për OSHC-të, por nuk ka mjete të realizuara. Komuna e Probishtipit me 31.4% të realizimit ka nivelin më të ulët të realizimit të mjeteve të dedikuara për sektorin civil.

Në grafikun nr. 50 tregohen shumën e buxhetuara dhe të realizuara të mjeteve për të gjitha zërat nga komunat që i përkasin rajonit Juglindor. Në këtë rajon ka dhjetë komuna, por vetëm shtatë komuna janë përfshirë në këtë studim, për të cilat janë siguruar informacione, të cilat janë: Bogdanci, Bosillova, Vallandova, Vasileva, Dojrani, Radovishi dhe Strumica.


Grafiku 50: Shuma të buxhetuara dhe të realizuara të mjeteve të komunave në rajonin Juglindor për vitin 2017



Brenda këtij rajoni, dallohen komunat e Strumicës dhe të Radovishit me më shumë mjete të ndara dhe të realizuara dhe me normat më të larta për realizimin e mjeteve të dedikuara për organizatat e shoqërisë civile. Komuna e Strumicës ka buxhetuar 8,450,000 denarë dhe ka realizuar 10,292,279 denarë, d.m.th. një normë realizimi prej 121.8%. Komuna e Radovishit ka planifikuar 7,248,000 denarë dhe ka realizuar 5,497,707 denarë, ose një normë realizimi prej 75.9%. Komunat e Dojranit dhe Vallandovës kanë respektivisht normat e realizimit prej 73.1% dhe 71.9%. Nivelin më të ulët të realizimit të mjeteve të buxhetuara brenda këtij rajoni, e ka komuna e Bogdancit, e cila ka realizuar vetëm 31.1% të mjeteve të parapara.

Në grafikun nr.51 tregohen fondet e buxhetuara dhe të planifikuara në mbështetje të sektorit civil për të gjitha zërat nga komunat që i përkasin rajonit të Pollogut. Ky rajon mbulon komunat Bogovinë, Bërvenicë, Gostivar, Zhelinë, Jegunovcë dhe Tetovë. Brenda këtij rajoni dallohen komunat e Gostivarit dhe Tetovës në raport me mjetet më të larta të ndara në vlerë absolute. Komuna e Gostivarit ka buxhetuar 5,600,000 denarë, ndërsa janë realizuar 3,767,500 denarë, kurse Komuna e Tetovës ka buxhetuar 7,770,000 denarë, ndërsa janë realizuar 1,529,200 denarë.

Grafiku 51: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara të komunave në rajonin e Pollogut për vitin 2017



Sa i përket shkallës së realizimit të mjeteve buxhetore, Komuna e Gostivarit dhe Komuna e Zhelinës dallohen respektivisht me normat e realizimit prej 67.3% dhe 42.2%. Komunat e Bogovinës, Tetovës,


Jegunovcit dhe Bërvenicës kanë norma të ulëta të zbatimit, respektivisht (20.7%, 19.7%, 19.3% dhe 14.2%).

5.1. Analizë krahasuese e shumave të buxhetuara dhe të realizuara sipas rajoneve të planifikimit për vitin 2017

Në kuadër të kësaj pjese janë analizuar të dhënat e mbledhura për shumat e buxhetuara dhe të realizuara në formën e mbështetjes financiare të organizatave të shoqërisë civile nga rajone të veçanta të planifikimit. Analiza sipas rajoneve të planifikimit është një analizë shumë e dobishme krahasuese sepse mund të shihet situata në rajone të caktuara dhe të shfrytëzohen informacionet në mënyrë që të dihet se në cilin rajon planifikimi nevojiten më shumë përmirësime.

Në grafikun nr. 52 është paraqitur një krahasim i shumave të buxhetuara dhe të realizuara nga rajonet e veçanta të planifikimit për vitin 2017. Sipas të dhënave në grafik, mund të konkludohet se në rajonin e Shkupit në vlerë absolute ka shuma më të larta të vlerës së buxhetuar dhe të realizuar. Në vend të dytë janë komunat që i përkasin rajonit Juglindor, kurse në vendin e tretë janë komunat që ndodhen në rajonin e Pollogut.

Grafiku 52: Krahasimi i shumave të buxhetuara dhe të realizuara sipas rajoneve të planifikimit për vitin 2017




Nëpërmjet krahasimit të relacioneve relative të dy llojeve të vlerave të buxhetuara dhe të realizuara, mund të nxirret një konkluzion mbi nivelin e realizimit të mjeteve të buxhetuara. Nivelin më të lartë të realizimit të mjeteve të buxhetuara e shënojnë komunat e rajonit të Vardarit, me nivelin e realizimit të mjeteve prej 99.8%. Më tej janë komunat që gjenden në rajonin Lindor me 91.6%, rajonin Juglindor me 83% dhe në fund janë komunat nga rajoni i Pellagonisë, ai Verilindor dhe i Pollogut, në të cilat shkalla e realizimit nuk tejkalon 51%.

6. Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara sipas komunave

Në vazhdim janë rezultatet e analizës së shumave të planifikuara dhe të realizuara të mjeteve për disa komuna dhe rajone karakteristike. Në grafikun numër 53 tregohet lëvizja e shumave të planifikuara dhe të realizuara të mjeteve për organizatat e shoqërisë civile nga komuna Sveti Nikollë, që i përket rajonit të planifikimit të Vardarit. Të dhënat i referohen periudhës 2013-2017.


Grafiku 53: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Sveti Nikollës për periudhën 2013 - 2017



Analiza e serisë kohore tregon se gjatë periudhës së analizuar, mjetet e buxhetuara dhe të realizuara rriten në mënyrë të vazhdueshme. Mjetet e planifikuara janë rritur nga 310,500 denarë në vitin 2013 në 1.730.000 denarë në vitin 2017. Mjetet e realizuara janë rritur nga 249,650 denarë për vitin 2013 në 1,440,000 denarë për vitin 2017. Në vitet 2014 dhe 2016, normat e realizimit të shumave të planifikuara të mjeteve arrijnë në 100%, kurse në vitet e tjera norma e realizimit është disi më e ulët.

Në grafikun nr. 54 janë treguar lëvizjet e shumave të buxhetuara dhe të planifikuara të dy komunave nga rajoni i Shkupit (Komunës së Aerodromit dhe Komunës së Çairit) për periudhën 2013-2017. Ndërsa në Komunën e Aerodromit seria kohore tregon një ndryshueshmëri të caktuar në lëvizjen e vlerave, mjetet e planifikuara dhe të zbatuara në Komunën e Çairit rriten në mënyrë të vazhdueshme.


Grafiku 54: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara të Komunës së Aerodromit dhe asaj të Çairit për periudhën 2013 – 2017



Pas rënies së mjeteve të realizuara në vitin 2015 në Komunën e Aerodromit, në vitin 2016, realizimi i tyre do të rritet përsëri. Në Komunën e Čairit çdo vit në vijim, edhe pse fondet e planifikuara dhe të realizuara janë rritur në shumë absolute, shkalla e realizimit të fondeve të planifikuara zvogëlohet në mënyrë të vazhdueshme.

Në grafikun nr. 55 është treguar lëvizja e fondeve të planifikuara dhe të realizuara në Komunën e Kërçovës si një komunë nga rajoni Jugperëndimor për periudhën 2013-2017.


Grafiku 55: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Kërçovës për periudhën 2013 – 2017



Nga grafiku mund të konkludohet lehtë se Komuna e Kërçovës nuk ka fonde të buxhetuara gjatë gjithë periudhës. Fondet e realizuara në periudhën 2013-2016 janë rritur vazhdimisht dhe në vitin 2016 kanë arritur shumën maksimale prej 8,050,000 denarë, por menjëherë pas kësaj në vitin 2017 është regjistruar rënia e tyre në nivelin 7,695,000 denarë.


Në grafikun nr. 56 janë treguar lëvizjet e shumave të planifikuara dhe të realizuara të mjeteve të akorduara për organizatat e shoqërisë civile nga komunat e Kriva Pallankës dhe Kumanovës. Në Komunën e Kriva Pallankës në mënyrë të vazhdueshme ka një normë të ulët të zbatimit të mjeteve buxhetore, kurse në vitin e fundit 2017, ka nivelin më të ulët të realizimit të mjeteve prej 95,000 denarësh. Por, në Komunën e Kumanovës ka një sasi konstante mjeteve të planifikuara prej 1.500.000 denarësh ndërsa fondet e realizuara deri në vitin 2015 janë në rritje, kurse menjëherë pas vitit 2015, deri në vitin 2017, ka një rënie të vazhdueshme.

Grafiku 56: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në komunate Kriva Pallankës dhe të Kumanovës për periudhën 2013 – 2017



Në grafikun nr. 57 tregohen lëvizjet e shumave të buxhetuara dhe të realizuara të Komunës së Resnjës dhe Komunës së Krivogashtanit si përfaqësuese të komunave të rajonit të Pellagonisë. Deri në vitin 2015, vlera e shumave të realizuara në Komunën e Resnjës shënon një trend rritës. Brenda së njëjtës periudhë kohore, vlera e shumave të buxhetuara ka një tendencë rënëse. Në vitin 2015, pjesëmarrja e vlerës së realizuar dhe asaj të buxhetuar në Komunën e Resnjës është më e larta. Nga viti 2016, fillon trendi rritës i të dy treguesve, dhe hendeuku midis tyre është zvogëluar dukshëm në krahasim me periudhën para vitit 2015.


Grafiku 57: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në komunat Resnjës dhe të Krivogashtanit për periudhën 2013 – 2017



Në Komunën e Krivogashtanit, e cila është treguar në grafikun e dytë, mund të vërehet se, ndryshe nga Komuna e Resnjës, ekziston një hendek i madh në vlerat e shumave të buxhetuara dhe të realizuara. Vëzhguar që nga viti 2016, shumat e realizuara fillojnë të bien, ndërkohë që shumat e buxhetuara, pavarësisht rënies së lehtë, mbeten të larta.


Në grafikun me numër rendor 58 tregohet lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Vinicës, si përfaqësuese e rajonit Lindor të planifikimit. Në periudhën 2013-2017, vlerat e mjeteve të buxhetuara me disa përjashtime tregojnë një prirje të lehtë rritëse. Ky trend ndiqet nga fondet e realizuara deri në vitin 2015, kur në Komunën e Vinicës ka një rënie të fondeve të realizuara. Një trend i tillë u ndërpre në vitin 2016, që në vitin 2017, shkalla e realizimit të arrijë nivelin e tij më të lartë.

Grafiku 58: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Vinicës për periudhën 2013 – 2017



Në grafikun nr. 59 tregohet lëvizjen e fondeve të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Strumicës dhe në Komunën e Radovishtit si komuna nga rajoni Juglindor i planifikimit. Mund të konkludohet se Komuna e Strumicës ka një shkallë të lartë të realizimit të fondeve të buxhetuara për të gjithë periudhën e analizuar. Lëvizja e mjeteve të buxhetuara ndiqet vazhdimisht nga mjetet e realizuara dhe duhet të theksohet se në një periudhë të caktuar këto shuma përputhen, d.m.th. shkalla e realizimit është mbi 95%.


Grafiku 59: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në komune Strumicës dhe të Radovishit për periudhën 2013 - 2017



Nga ana tjetër, Komuna e Radovishit deri në vitin 2015 shënon devijim të madh në vlerat e shumave të buxhetuara dhe të realizuara të mjetëve. Në vitin 2015, këto dy shuma bien në rreth 7 000 000 denarë të mjetëve të buxhetuara dhe 4 739 310 denarë mjetë të realizuara, me çka dallimi mes tyre në krahasim me vitet e kaluara është zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme. Në periudhën në vijim, të dy madhësitë tregojnë një lëvizje të konsoliduar me një trend të butë rritës të mjetëve të buxhetuara.


Grafiku me numër rendor 60 i paraqet shumat e fondeve të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Tetovës dhe atë të Gostivarit si komuna që i përkasin rajonit planifikues të Pollogut. Në grafikun e parë tregohen vlerat e shumave të planifikuara dhe të realizuara të buxhetit për Komunën e Tetovës. Duhet të theksohet se shumat karakterizohen me devijime të mëdha dhe nuk vërehet një trend i dukshëm në lëvizje. Megjithatë, mund të konkludohet se duke filluar nga viti 2015, shuma e mjetëve të buxhetuara tregon një tendencë rritjeje, ndërsa shuma e aktiveve të realizuara shënon një tendencë rënëse. Nga ana tjetër, grafiku i dytë tregon lëvizjen e shumave të buxhetuara dhe të realizuara për Komunën e Gostivarit. Ndryshe nga Komuna e Tetovës, shumat e mjetëve të realizuara dhe të buxhetuara në Komunën e Gostivarit shënojnë lëvizje ciklike përgjatë periudhës së analizuar.

Grafiku 60: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Tetovës për periudhën 2013 – 2017



Nga ana tjetër, grafiku i dytë tregon lëvizjen e shumave të buxhetuara dhe të realizuara për Komunën e Gostivarit. Ndryshe nga Komuna e Tetovës, shumat e mjetëve të realizuara dhe të buxhetuara në Komunën e Gostivarit shënojnë lëvizje ciklike ulje-ngritje përgjatë periudhës së analizuar.

Grafiku 61: Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara në Komunën e Gostivarit për periudhën 2013 – 2017




7. Lëvizja e shumave të buxhetuara dhe të realizuara sipas rajonevetë veçanta të planifikimit dhe në nivel kombëtar 2013 – 2017

Në kuadër të këtij seksioni janë paraqitur rezultatet e analizës krahasuese të fondeve të buxhetuara dhe të realizuara në mbështetje të organizatave të shoqërisë civile sipas rajoneve planifikuese të përzgjedhura. Krahasim i rajoneve planifikuese është një mjet shumë i dobishëm që mund të shërbejë në të ardhmen për krijimin e politikave më të mira dhe realizimin e projekteve që konkretisht do të fokusohen në komunat që u përkasin rajoneve të veçanta të planifikimit, ku është i nevojshëm përmirësimi i planifikimit të buxhetimit.


Në grafikun vijues tregohen shumat e buxhetuara dhe të realizuar të mjeteve të komunave nga rajoni Jugperëndimor i planifikimit për periudhën 2013 - 2017. Duhet të theksohet se kjo analizë përfshin vetëm komunat që ofruan të dhëna për punën e tyre, d.m.th. iu përgjigjën Kërkesës për të dhëna me karakter publik.

Grafiku 62: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin Jugperëndimor të planifikimit



Në grafikun nr. 62 janë dhënë rezultatet për rajonin Jugperëndimor të planifikimit, duke përfshirë komunat Ohër, Strugë, Debarcë, Kërçovë dhe Makedonski Brod, kurse komunat e tjera në rajon, janë përgjigjur se për periudhën e analizuar nuk kanë mjete të buxhetuara dhe të realizuara. Nga grafiku mund të konkludohet se shumat e realizuar të mjeteve duke filluar që nga viti 2013 ka një tendencë në rënie. Gjithashtu, mjetet e buxhetuara, të cilat në vlerë absolute janë më të larta se ato të realizuara, e ndjekin të njëjtin trend. Në vitin 2016, ka një ngushtim të hendeut midis shumave të buxhetuara dhe të realizuara të mjeteve.


Grafiku 63: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin e planifikimit të Pollogut



Në grafikun nr. 63 paraqiten shumat e mjeteve të buxhetuara dhe të realizuar të komunave të rajonit të planifikimit të Pollogut për periudhën 2013-2017. Komunitet e përfshira në këtë analizë, d.m.th. ato që i janë përgjigjur Kërkesës për të dhëna me karakter publik janë komunat: Bërvenicë, Gostivar, Zhelinë, Jegunovcë dhe Tetovë. Sipas të dhënave të disponuara, mund të thuhet se të dy treguesit shënojnë një tendencë në rënie. Gjithashtu mund të vërehet se ekziston një hendek i lartë midis shumave të buxhetuara dhe atyre të realizuara. Shumat e buxhetuara në vitin 2017 në këtë rajon planifikimi fillojnë të rriten, ndërsa për shumën e realizuar, nuk ka të dhëna të disponueshme.

Më poshtë, në grafikun nr. 64 paraqiten rezultatet për shumën e buxhetuara dhe të realizuar për rajonin Verilindor të planifikimit.


Grafiku 64: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin Verilindor të planifikimit



Komunitet që bëjnë pjesë në rajonin Verilindor të planifikimit janë: Kriva Pallanka, Kumanova, Rankovci dhe Nagoriçani i Vjetër. Likova dhe Kratova nuk kanë dorëzuar të dhëna. Në qoftë se ndiqet lëvizja e vlerës së realizuar në periudhën prej vitit 2013 deri në vitin 2017 mund të konkludohet se kjo është një vijë e drejtë, d.m.th. nuk tregon ndonjë ndryshim të rëndësishëm në periudhën e analizuar. Nga ana tjetër vlera e buxhetuar me përjashtim të vitit 2015 tregon një sasi që është më e ulët se vlera e realizuar. Në këtë rajon komunitet e tejkalojë shumën e buxhetuar të fondeve të destinuara.

Në grafikun nr. 65 tregohen tendencat e shumave të buxhetuara dhe të realizuara të mjeteve në formën e mbështetjes për sektorin civil në rajonin Lindor të planifikimit.


Grafiku 65: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin Lindor të planifikimit



Komunat që i përkasin rajonit Lindor të planifikimit janë: Vinica, Delçeva, Zërnovci, Karbinci, Koçani, Probishtipi dhe Çeshinovë - Oblesheva. Nëse analizohet vlera e realizuar e komunave në këtë rajon, mund të konkludohet se me përjashtim të vitit 2016 ka një trend rritës dhe është më e lartë se vlera e buxhetuar. Nga ana tjetër, vlera e buxhetuar tregon një trend më të butë rritës.

Grafiku 66 tregon tendencat e shumave të buxhetuara dhe të realizuara të mjeteve për komunat që i përkasin rajonit planifikues të Shkupit për të njëjtën periudhë 2013-2017.


Grafiku 66: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin e planifikuar të Shkupit



Në kuadër të rajonit të Shkupit kemi të dhëna për komunat Aerodrom, Butel, Gazi Babë, Gjorçe Petrov, Kisella Vodë, Çair, Shuto Orizare, Ilinden, Petrovec, Sopishtë dhe Çuçer Sandevë. Është e dukshme rritja e fondeve buxhetore në periudhën e analizuar nga 20,641 milionë denarë në 43,850 milionë denarë. Ndërmjet viteve 2015-2016 ka një kërcim të madh të mjeteve të planifikuara prej rreth 15 milionë denarësh. Mjetet e realizuara në periudhën 2013-2015 janë në rënie deri në 19,520 milionë denarë dhe në periudhën e ardhshme ato pësojnë rritje deri në nivelin prej 30,023 milionë denarësh. Deri në vitin 2015, realizohen më shumë mjete në raport me ato të planifikuara, kurse në vitet në vijim, realizohen më pak mjete në raport me ato të planifikuara.

Në grafikun 67 tregohen tendencat për shumatat e buxhetuara dhe të realizuara të mjeteve për komunat që i përkasin rajonit të Vardarit.


Grafiku 67: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin e planifikuar të Vardarit



Gjatë analizimit të tendencave të treguara në këtë grafik, të dhënat u grumbulluan nga komunat Gradsko, Llozovë dhe Sveti Nikollë. Për këtë rajon planifikimi, është e dukshme tendenca rritëse në aktivitetet e planifikuara dhe të realizuara. Me përjashtim të vitit të kaluar, mjetet janë realizuar mbi mesataren e planifikuar prej 158%, dhe në vitin e kaluar mjetet e buxhetuara janë realizuar pothuajse plotësisht.

Në grafikun nr. 68 analizohen tendencat e mjeteve të buxhetuara dhe faktikisht të realizuara për periudhën 2013-2017 për komunat që i përkasin rajonit të Pellagonisë.


Grafiku 68: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin e planifikimit të Pellagonisë



Në kuadër të rajonit të Pellagonisë, komunat që përfshihen në analizën e këtij studimi janë: Manastiri, Demir Hisari, Krivogashtani, Krusheva, Resnja dhe Novaci. Në periudhën 2013-2017, mjetet e buxhetuara mesatarisht realizohen deri në 50%. Fondet e buxhetuara pas vitit 2014, dhe mjetet e realizuara pas vitit 2015 kanë një tendencë të konsiderueshme rënëse.

Në grafikun e mëposhtëm me numër rendor 69, analizohen të dhënat për rajonin Juglindor të planifikimit dhe komunat që e përfaqësojnë këtë rajon si: Bogdanci, Bosillova, Vallandova, Vasileva, Gjevgjelia, Dojrani, Radovishi dhe Strumica.


Grafiku 69: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në rajonin Juglindor të planifikimit



Në periudhën 2013-2017, fondet e buxhetuara kanë rënë nga 43,004 milion denarë në 26,240 milionë denarë dhe mjetet e realizuara u zvogëluan nga 36,467 milionë denarë në 21,969 milionë denarë. Në periudhën e analizuar, mesatarisht, mjetet e buxhetuara u realizuan me një shkallë prej 82%.


Përveç nevojës për të bërë një analizë krahasuese të shumave të buxhetuara dhe realisht të realizuara të mbështetjes financiare nga komunat në drejtim të sektorit civil, është shumë e dobishme të bëhet një analizë krahasuese totale në nivel kombëtar. Prandaj, në grafikun e mëposhtëm numër 70, është paraqitur raporti buxhetim - realizim në nivel kombëtar (duke i marrë parasysh komunat që janë pjesë e analizës sonë). Nga grafiku shihet se devijimet më të mëdha nga mjetet e planifikuara janë për vitin 2016, kur realizimi është vetëm 62%, si dhe në 2015 kur kemi realizim të mjeteve për sektorin civil me më shumë se 20% nga ato të planifikuara. Në periudhën e mbetur, çdo vit realizimi i mjeteve për organizatat e shoqërisë civile ka qenë mesatarisht më i ulët deri në 5% nga ato të planifikuara.

Grafiku 70: Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në nivel kombëtar



Nga grafiku shihet se devijime më të mëdha nga mjetet e planifikuara kemi për vitin 2016, kur realizimi është vetëm 62%, si dhe në vitin 2015 kur kemi realizimetë mjeteve për sektorin civil me më shumë se 20% nga të planifikuarat. Në periudhën e mbetur, çdo vit realizimi i mjeteve për organizatat e shoqërisë civile ishte mesatarisht më i ulët deri në 5% nga të planifikuarat.

Grafiku 71 - Shumat e buxhetuara dhe të realizuara në nivel kombëtar



ANALIZË KUALITATIVE E INTERVISTAVE TË REALIZUARA

Në kuadër të këtij seksioni janë prezantuar rezultatet e intervistave të kryera me përfaqësuesit e komunave dhe organizatave të shoqërisë civile. Përzgjedhja e komunave në të cilat janë bërë intervista ishte në bazë të asaj se cilat komuna nuk i janë përgjigjur pyetësorit dhe Kërkesës për qasje në informacionin publik, në mënyrë që të marrin më shumë informacion në lidhje me situatën në këto komuna, por edhe në komunat të cilat në mënyrë të dukshme kanë rezultate të mira në mënyrë që të marrin më shumë informacion mbi praktikatat e tyre të mira. Mbi këtë bazë u kryen intervista në komunat Demir Kapi, Kavadar, Veles, Qendër, Gazi Babë, Radovish, Gjorçe Petrov, Kisella Vodë, Kumanovë, Makedonska Kamenica, Shtip, Çair, Shuto Orizarë, Sveti Nikollë dhe Haračinë.

Përmbajtja e intervistave analizohet përmes disa metodave themelore: 1) Identifikimi i ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet të anketuarve 2) Identifikimi i përsëritjeve ose fjalëve kyçe që përsëriten përmes intervistave dhe 3) Identifikimi i varësisë shkak-efekt të theksuar nga të anketuarit. Megjithatë, analiza u bazuar kryesisht në identifikimin e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet komunave të veçanta dhe në përputhje me to, bëhet kategorizimi i komunave të paraqitura më poshtë në tabelën nr. 7

Tabela nr. 7: REZULTATE NGA INTERVISTAT E REALIZUARANË KOMUNA	
Pyetje	Konkluzione
1. Shpërndarja e mjeteve financiare për OSHC-të	1) Të gjitha komunat e intervistuar ndajnë mjete financiare për organizatat e shoqërisë civile.
2. Statusi ligjor i OSHC-ve që përkrahen financiarisht nga komunat	2) Në të gjitha komunat e intervistuar dominojnë tri forma të statusit ligjor të OSHC-ve të cilat mbështeten financiarisht: - Shoqata qytetare - Parti politike - Klube sportive
3) Mbështetje financiare në nivel lokal, kombëtar ose në kuadër të rajonit të planifikimit	3) Shumica e komunave (mbi 90%) u ndajnë fonde kryesisht organizatave të shoqërisë civile që veprojnë në nivel lokal dhe brenda rajonit të planifikimit në të cilin përket komuna. Vetëm një pjesë e vogël e komunave ndajnë mjete për organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në nivel kombëtar.
4) Fushat e veprimtarisë së organizatave të shoqërisë civile që marrin mbështetje financiare nga komunat	4) Në të gjitha komunat nuk ka ndonjë dallim të rëndësishëm në aspektin e fushëveprimit të aktiviteteve të OSHC-ve të mbështetura financiarisht nga komunat. Më shpesh fushat e veprimtarisë janë: aktivitetet vullnetare/humanitare, aktivizmi qytetar, arti dhe sporti, personat me nevoja të veçanta, marrëdhëniet ndëretnike dhe të drejtat e njeriut, mjedisi dhe burimet natyrore si dhe kultura.
5) Aktet e brendshme për financimin e OSHC-ve	5) Pothuajse gjysma e komunave të intervistuar nuk kanë miratuar rregullore të brendshme, procedura apo akte për mënyrën e mbështetjes financiare të OSHC-ve.
6) Fushat prioritare për ndarjen e mjeteve	6) Shumica e komunave nuk kanë fusha prioritare për financim
7) Shpallja e thirrjes publike për dhënien e mjeteve për financimin e OSHC-ve	7) Shumica e komunave shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve financiare nga komuna, dhe këtë e bëjnë më shpesh në faqen e tyre të internetit, si dhe në televizionet dhe radiostacionet lokale. Një numër më i vogël i komunave punojnë gjithashtu në zhvillimin e një modeli për strukturën e propozim - projektit dhe dorëzimin e kërkesave për financim nga komunat.
8) Marrja e vendimit për dhënien e mjeteve dhe publikimi i tij	8) Në pjesën më të madhe të komunave të intervistuar vendimi merret nga këshillat e komunës dhe në një numër më të vogël ekziston një komision që e merr vendimin. Shumica e komunave e shpallin publikisht vendimin në gazetë zyrtare dhe rrallë në faqen e tyre të internetit.
9) Monitorimi i realizimit të aktiviteteve të projektit dhe	9) Pothuajse të gjitha komunat e intervistuar nuk kryejnë monitorimin e realizimit të projekteve nga organizatat e shoqërisë civile, kurse shumica e

përgatitja e një raporti vjetor për projektet e realizuara	komunave nuk publikojnë raporte vjetore mbi projektet e realizuara nga organizatat qytetare të mbështetura nga vetëqeverisja lokale.
10) Njësi organizative ose person përgjegjës për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile	10) Pothuajse të gjitha komunat nuk kanë një njësi të veçantë organizative në komunë për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Ajo që është praktikë e rregullt për shumicën e komunave është që ky rol t'i caktohet një personi nga sektori i ZHEL-it (Zhvillimi Ekonomik Lokal) ose një person nga sektori juridik i komunës.
11) Përfshirja e organizatave të shoqërisë civile	11) Në pak më shumë se gjysmën e komunave të anketuara, organizatat e shoqërisë civile janë të përfshira në përgatitjen e buxhetit komunal duke paraqitur kërkesat e tyre dhe duke ofruar sugjerime për financimin e aktiviteteve të caktuara të projektit të sektorit civil.
12) Sistemi i ndarjes së pikëve dhe vlerësimittë projekteve dhe transparenca e tij	12) Shumica e komunave të anketuara kanë deklaruar se nuk kanë një sistem të përcaktuar qartë për vlerësimin e projekt propozimeve të dorëzuara nga OSHC-të. I njëjtë është rasti edhe në lidhje me transparencën, pra pothuajse të gjitha komunat kanë deklaruar se nuk kanë asnjë praktikë për të shpallur publikisht sistemin e vlerësimit në një mediumi si faqja e tyre e internetit apo gazeta zyrtare.
13) Diapazoni dhe madhësiaefinancimit dhe matjes së efekteve të aktiviteteve të realizuara të projektit	13) Shumica e komunave të anketuara janë përgjigjur se financimi i OSHC-ve kryesisht korrespondon nga aspekti i diapazonit, por jo nga aspekti i shumës së fondeve që janë ndarë për këtë qëllim. Numri dominues d.m.th. pothuajse të gjitha komunat nuk praktikojnë matjen e efekteve të aktiviteteve të realizuara të projektit nga organizatat e shoqërisë civile.
14) Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe mbështetja in kind.	14) Shumica e komunave të intervistuar deklaruan se nuk kishin nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile. Sa i përket mbështetjes in kind, komunat në mënyrë dominuese deklarojnë se prej tyre nuk është kërkuar një mbështetje e tillë dhe për këtë arsye ajo zakonisht nuk është dhënë.
15) Niveli i mbështetjes financiare në 5 vitet e fundit dhe niveli i konsultimit me sektorin civil.	15) Shumica e komunave deklaruan se ata e kanë rritur mbështetjen e tyre financiare për organizatat e shoqërisë civile në vitet e fundit. Por kur bëhet fjalë për nivelin e konsultimit me sektorin civil në përcaktimin e aktiviteteve që duhet të mbështeten, shumica e komunave janë përgjigjur se ky lloj konsultimi nuk është përmirësuar në 5 vitet e fundit.
16) Prioritetet që më së shumti janë mbështetur financiarisht nga komunat dhe përfitimet prej tyre.	16) Më shpesh, komunat nuk dallohen nga aspekti i prioriteteve që ato mbështesin financiarisht. Më shpesh ato janë: kultura, sporti, turizmi, arti, aktivizmi civil, arsimi, mjedisi, pensionistët, burimet natyrore, zhvillimi rajonal, përmirësimi i imazhit të komunës, fëmijët dhe të rinjtë, çështjet gjinore, aktivitetet humanitare, Nga aspekti i përfitimeve, komunat mendojnë se më shumë dobi nga realizimi i këtyre projekteve kanë qytetarët, veçanërisht në nivel lokal dhe brenda rajonit të planifikimit.

Krahas intervistave me përfaqësuesit e komunave, u zhvilluan dhe 15 intervista me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile për të krahasuar përgjigjet midis dy palëve dhe për të parë dallimet e mundshme. Analiza cilësore e të dhënave të intervistave është dhënë më poshtë në tabelën numër 8.

Tabela nr. 8: REZULTATE NGA INTERVISTAT E REALIZUARAME ORGANIZATAT QYTETARE	
Pyetje	Konkluzione
1) Niveli i bashkëpunimit me komunat	1) Shumica e OSHC-ve theksojnë se kanë bashkëpunim relativisht të mirë me autoritetet lokale, por marrëdhëniet personale me kryetarin e komunës luajnë një rol të rëndësishëm në nivelin e bashkëpunimit. Disa organizata të shoqërisë civile haptazi theksojnë se bashkëpunimi më i madh është realizuar në ato kohë kur dikush nga organizatat civile ka marrëdhënie më të ngushta personale me kryetarin e komunës. Megjithatë, bashkëpunimi me autoritetet lokale është shumë më intensiv në krahasim me bashkëpunimin që organizatat civile kanë me autoritetet qendrore. Sidoqoftë, organizatat e shoqërisë civile konsiderojnë se është e nevojshme të mbahen takime të rregullta në mes të sektorit të shoqërisë civile dhe komunave për të përmirësuar bashkëpunimin.
2) Përfshirja në krijimin e politikave dhe përgatitjen e buxhetit.	2) Shumica e OSHC-ve kanë deklaruar se shpesh kanë mundësi të marrin pjesë në krijimin e buxhetit dhe politikave në nivel lokal duke ofruar propozime për mbështetje financiare për aktivitete të caktuara të projektit që janë fusha të veprimit të organizatës civile. Por në të njëjtën kohë, organizatat e shoqërisë civile theksojnë se komunat kanë mekanizma dhe procedura modeste për përfshirjen e publikut në punën e tyre. Ata theksojnë se nevojitet vullnet më i madh politik dhe qasje e strukturuar për përfshirjen e sektorit civil dhe të gjithë faktorëve lokalë në krijimin e strategjive dhe politikave.
3) Kriteret për dhënien e mjeteve financiare për OSHC-të	3) Shumica e OSHC-ve konfirmuan se komunat nuk kanë kriteret të qarta për ndarjen e mjeteve për sektorin civil. Shpesh në komunat më të vogla ka vetëm disa organizata të shoqërisë civile dhe të gjitha mjetet i marrin këto organizata.
4) Monitorimi dhe përgatitja e një raporti mbi aktivitetet e realizuara	4) Numri më i madh i OSHC-ve thanë se shumica e komunave nuk kryejnë monitorimin e realizimit të aktiviteteve të projektit të mbështetura financiarisht nga vetë komuna.
5) Njësi organizative ose person për kontakt me sektorin civil	5) Shumica e OSHC-ve thanë se kryesisht bashkëpunojnë me një person, i cili është ngarkuar nga komuna për bashkëpunim me OSHC-të dhe që më shpesh i takon një sektori apo njësie tjetër siç janë ZHEL-i ose sektori juridik.
6) Njohja me sistemin e vlerësimit, evaluimit dhe transparencës së tij	6) Shumica e OSHC-ve theksojnë se nuk janë të njohur me sistemin e vlerësimit të projekteve nga ana e komunave. Një numër i tyre konsiderojnë se komunat nuk kanë fare kriteret të përcaktuara për vlerësimin e projekt propozimeve dhe se kjo është arsyeja kryesore pse ato nuk janë shpallur publikisht. Sidoqoftë, organizatat e shoqërisë civile konsiderojnë se shumë nga komunat nuk kanë kriteret të qarta për vlerësimin e projekteve me qëllim që në mënyrë autonome, në bazë të bindjes së tyre të mund të vendosin se cilat projekte do t'i mbështesin financiarisht. Gjithashtu, organizatat e shoqërisë civile konsiderojnë se në këtë mënyrë komunat duan të shmangin kundërshtimet e mundshme nga projektet e refuzuara mbi bazën e një sistem të tillë të vlerësimit.
7) Diapazoni dhe madhësia financimit dhe matja e efekteve të aktiviteteve të realizuara të projektit	7) Ndryshe nga komunat që konsiderojnë se diapazoni i financimit është i kënaqshëm dhe se duhet të përmirësohet vëllimi i financimit, shumica e OSHC-ve konsiderojnë se fondet e ndara për të mbështetur aktivitetet e tyre nuk janë të mjaftueshme as nga aspekti i diapazonit, as nga aspekti i madhësisë. Ata mendojnë se kryesisht dominojnë disa fusha të tilla si sporti dhe kultura, dhe shumë më pak fusha të tjera si mjedisi, personat me aftësi të kufizuara, marrëdhëniet ndëretnike dhe aktivitetet humanitare.
8) Niveli i mbështetjes	8) Shumica e OSHC-ve të përfshira në intervista theksojnë se gjatë 5

financiare në 5 vitet e fundit.	viteve të fundit nuk ka pasur rritje dramatike të mbështetjes financiare për aktivitetet e tyre. Madje disa prej tyre theksojnë se shumë shpesh të njëjtat organizata të shoqërisë civile i marrin përafërsisht të njëjtat mjetefinanciare për realizimin e të njëjtave aktivitete të projektit. Megjithatë, ato tregojnë se ndryshimi i kryetarëve të komunave mund të krijojë pasiguri nëse kryetari i ri do të vazhdojë të mbështesë financiarisht ndonjë aktivitet. Qëndrimi i tyre është i ngjashëm edhe për nivelin e konsultimeve që ata kanë me komunat, dhe ai është se në 5 vitet e fundit, gjërat nuk kanë ndryshuar në mënyrë dramatike.
9) Mbështetja jofinanciare (in kind)	9) Shumica e OSHC-ve theksojnë se ato rrallë kërkojnë një lloj ndihme in kind nga komunat dhe se ato janë kryesisht të orientuara drejt kërimit të mbështetjes financiare. Megjithatë, një pjesë e OSHC-ve thonë se kërkojnë edhe ndihmë të këtillë nga komunat dhe shpesh ata marrin përgjigje pozitive prej tyre.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Bazuar në analizën e të dhënave nga burimet primare dhe sekondare për mbështetjen financiare dhe jofinanciare të organizatave të shoqërisë civile nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, në kuadër të të gjithë studimit, mund të nxirren disa përfundime kyçe. Përfundimet e këtij studimi janë paraqitur më poshtë në tabelën nr. 9. Në bazë të konkluzioneve të nxjerra, në kapitullin vijim janë gjeneruar rekomandime për përmirësimin e zonave të identifikuar si kritike për përmirësimin e nivelit të bashkëpunimit ndërmjet komunave dhe sektorit civil.

Tabela nr. 9: PËRFUNDIMET NGA ANALIZA E TË DHËNAVE

1). Kryesisht komunat i financonë organizatat e shoqërisë civile që kanë status ligjor të shoqatave qytetare dhe klubeve sportive. Për këtë arsye, aktivitetet që kryesisht mbështeten nga njësitë e qeverisjes lokale janë artet dhe sportet, aktivitetet sociale, arsimi dhe edukimi, aktivitetet vullnetare dhe humanitare.
2). Pothuajse 2/3 e komunave nuk i kanë përcaktuar fushat prioritare për shpërndarjen e mjeteve. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, shumica e komunave në rajonin Jugperëndimor nuk i kanë përcaktuar fushat prioritare për mbështetje financiare.
3). Pak më shumë se ½ e komunave shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve financiare nga ana e komunave. Vrojtuar sipas rajoneve të planifikimit, rajoni Jugperëndimor, ai i Shkupit dhe Rajoni Juglindor janë me numrin më të madh të komunave që nuk shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve për mbështetje të sektorit civil.
4). Shpallja e thirrjeve publike zakonisht bëhet përmes faqes së internetit të komunës, portaleve lokale të internetit dhe stacioneve lokale televizive dhe të radios.
5). Një numër relativisht i madh ose pothuajse 2/3 e komunave deklaruan se ata posedojnë një strukturë të qartë për dorëzimin e një propozim projekti. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, komunat e rajonit Jugperëndimor dhe atij të Pollogut nuk kanë zhvilluar një strukturë për dorëzimin e projekt propozimeve.
6). Shumica e komunave deklaruan se nuk posedojnë kriteret të qarta për vlerësimin e projekt propozimeve dhe se ato, gjegjësisht sistemi i vlerësimit për projekt propozimet, në shumicën e komunave nuk ishte shpallur publikisht.
7). Gjysma e komunave ose pothuajse 50% deklaruan se ato marrin vendim për projektet të cilat do të mbështeten financiarisht nga komuna.
8). Më shumë se gjysma e komunave të anketuara treguan qartë se nuk i shpallin publikisht projektet e mbështetura financiarisht nga komuna.
9). Shumica e komunave, ose mbi 80%, tregojnë se OSHC-ve u kërkohet të dorëzojnë një raport mbi aktivitetet e realizuara të projektit të mbështetura financiarisht nga komuna.
10). Pak më shumë se gjysma e komunave kanë raportuar se përgatisin një raport vjetor mbi fondet e ndara për organizatat e shoqërisë civile dhe se monitorojnë realizimin e aktiviteteve të projektit. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, shumica e komunave në rajonin Jugperëndimor, të Pollogut dhe atë të Shkupit nuk kanë praktika të tilla.
11). Më shumë se gjysma e komunave kanë raportuar se nuk kanë një sektor të veçantë për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe se më së shpeshti komunat kanë angazhuar një person për këtë lloj bashkëpunimi që i përket një sektori tjetër, më së shpeshti në kuadër të sektorit ZHEL (Zhvillimi Ekonomik Lokal), sektorit juridik, sektorit për aktivitete publike dhe sektorë të tjerë.
12). Shumica ose mbi 80% e komunave mendojnë se projektet e realizuara nga OSHC-të ofrojnë përfitime më të gjera për qytetarët dhe shoqërinë. Megjithatë, në të njëjtin numër, komunat deklaruan se nuk i matin efektet e aktiviteteve të realizuara të projektit nga organizatat civile.
13). Komunat mendojnë se mbështetja financiare e OSHC-ve i përgjigjet diapazonit dhe vëllimit, ndërsa organizatat e shoqërisë civile mendojnë se mbështetja financiare nuk është në nivelin e kërkuar, as nga vëllimi as nga diapazoni..

- 14). Shumica e komunave mendojnë se bashkëpunimi me OSHC-të është përmirësuar në 5 vitet e fundit, ndërsa shumica e OSHC-ve konsiderojnë se një bashkëpunim i tillë nuk ka ndryshuar dukshëm në 5 vitet e fundit.
- 15). Komunat raportuan se për 5 vitet e fundit ata kanë promovuar mbështetjen jofinanciare (in kind) të organizatave të shoqërisë civile. Megjithatë, një pjesë e tyre tregojnë se ky lloj mbështetjeje kërkohet rrallë prej tyre. Shumica e OSHC-ve kanë të njëjtin qëndrim, duke vënë në dukje se ata me të vërtetë e kërkojnë më rrallë këtë lloj mbështetje.
- 16). Më i madh është bashkëpunimi i komunave me sektorin civil në projekte që përkrahen financiarisht nga komunat se sa ato që mbështeten nga një donator i huaj.
- 17). Bashkëpunimi në mes të komunave dhe organizatave të shoqërisë civile është më i madh gjatë zbatimit të projekteve publike sesa në projekte për monitorimin dhe ndjekjen e politikave.
- 18). Është konstatim i përgjithshme se në të gjitha rajonet e planifikimit ekzistojnë komuna që kanë devijime të mëdha ndërmjet fondeve të planifikuara dhe atyre të realizuara për mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile. Për shumicën e komunave, vlerat planifikuar është më e lartë se vlerat realizuar. Vëzhguar sipas rajoneve të planifikimit, devijime më të vogla ekzistojnë në rajonin e Shkupit, të Pelagonisë dhe në rajonin Juglindor.
- 19). Tendencat në buxhetimin dhe realizimin e mjeteve financiare sipas komunave të veçanta, tregojnë se ka devijime në dy drejtime, d.m.th. është tejkaluar vlera e planifikuar në raport me atë të realizuar dhe anasjelltas. Por ka edhe komuna që gjatë viteve kanë devijim relativisht të vogla të mjeteve të buxhetuara dhe të realizuar për mbështetjen e projekteve në sektorin civil.
- 20). Realizim më i dobët i fondeve të planifikuara për sektorin civil është vërejtur në rajonin Juglindor, Jugperëndimor, atë të Pellagonisë dhe të Pologut, ndërkohë që realizimi i dukshëm më i lartë nga buxhetimet/planifikimet e mëparshme u vërejt në rajonin e Vardarit dhe atë Lindor.
- 21). Devijimet më të mëdha nga mjetet e planifikuara për OSHC-të janë në vitin 2016, kur realizimi është vetëm 62%, si dhe në vitin 2015, kur kemi realizim të mjeteve për sektorin civil pothuajse më shumë se 20% nga të planifikuarat. Në pjesën e mbetur, çdo vit realizimi i mjeteve për OSHC-të ishte më i ulët në interval deri në 5% nga të planifikuarat.

8. REKOMANDIME

Në bazë të konkluzionve të paraqitura në tabelën nr. 9, mund të nxirren disa rekomandime të rëndësishme. Rekomandimet janë treguar më poshtë në tabelën nr. 10

TABELA 10: REKOMANDIME QË DALIN NGA PËRFUNDIMET

1). Është e nevojshme që komunat ta ndryshojnë në një farë masë fokusin në financimin e aktiviteteve të organizatave të shoqërisë civile, nga sporti dhe arti më shumë te mjedisi, njerëzit me aftësi të kufizuara, marrëdhëniet ndëretnike dhe aktivitetet humanitare.
2). Nevojitet forcimi i kapaciteteve të autoriteteve lokale në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile për të përcaktuar me saktësi fushat prioritare për financim. Kjo vlen për të gjitha rajonet e planifikimit, dhe veçanërisht për komunat e rajonit Jugperëndimor të planifikimit.
3). Duhet të rritet në mënyrë të konsiderueshme numri i komunave që do të shpallin thirrje publike për dhënien e mjeteve për projektet e drejtuara nga organizatat e shoqërisë civile. Një obligim i tillë mund t'u imponohet komunave duke e ndryshuar legjislacionin në të ardhmen.
4). Ndhmë për komunat në përpunimin e një strukture të qartë për dorëzimin e projekt propozimeve nga sektori civil. Gjithashtu, t'u ndihmohet komunave që të zhvillojnë një metodologji të plotë për financimin e projekteve të sektorit civil. Brenda kësaj metodologjie duhet të përcaktohet i tërë procesi që nga shpallja e thirrjes publike, ndarja e mjeteve financiare, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të projektit e deri te matja e efekteve.
5). Krahas zhvillimit të një metodologjie të plotë dhe të dokumentacionit sipas modelit të nevojshëm për të ndjekur një proces të tillë, është e nevojshme të sigurohet transparencë e fortë e procesit të dhënies nga komunat të granteve për projekte të organizatave të shoqërisë civile.
6). Natyrisht, do të ishte e dobishme të krijohej një zgjidhje e digjitalizuar për dorëzimin në komuna të projekt propozimeve nga organizatat e shoqërisë civile. Zgjidhja digjitale mund të sigurojë transparencë më të madhe dhe ndjekje të projekt propozimeve përmes procesit të mbështetjes financiare së bashku me publikimin përfundimtar të projekteve që kanë marrë mbështetjen. Një platformë e tillë mund të centralizohet dhe të përdoret nga të gjitha komunat anëtare të BNJVL-së, me çka do të sigurohej standardizimi i procedurës për shpërndarjen e mjeteve dhe gjithashtu do të ndihmohen komunat më të vogla që nuk kanë kapacitete për zhvillim dhe mirëmbajtje të platformës .
7). Është e detyrueshme të rritet numri i komunave që matin efektet e projekteve të realizuara nga organizatat e shoqërisë civile. Përfitimet aktuale për shoqërinë bazohen vetëm në supozimet e bëra nga komunat dhe shoqëria civile. Por duhet të ketë monitorim dhe matje të efekteve në mënyrë që të dihet nëse aktivitetet me të vërtetë kontribuan në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.
8). Është e domosdoshme që OShC-të të jenë më aktive dhe ta përdorin më shumë ndihmën jofinanciare ose in kind të komunave.
9). Nevojitet përfshirje më e madhe e OSHC-ve dhe bashkëpunim më i madh në fushën e monitorimit dhe vlerësimit të politikave lokale.
10). Rritje e numrit të komunave që përgatisin një raport të veçantë vjetor për mjetet e shpenzuara për financimin e organizatave të shoqërisë civile. Kjo mund të arrihet nëpërmjet ndryshimit të legjislacionit dhe duke futur një obligim të tillë në kuadrin e rregullores.
11). Arritja e përputhshmërisë më të madhe në mes të komunave dhe organizatave të shoqërisë civile në aspektin e vëllimit dhe të diapazonit të fushave të mbështetura financiarisht nga komunat.
12). Nevojitet përmirësimi i kapaciteteve të komunave për buxhetim më të mirë të aktiviteteve të organizatave të shoqërisë civile, por edhe realizimi më i mirë i shumave të planifikuara, në mënyrë që të mos ndodhin boshllëqe dhe devijime të mëdha ndërmjet planifikimeve dhe realizimeve.



Ky botim është përgatitur me ndihmën e Bashkimit Evropian, në kuadër të projektit "Organizatat e shoqërisë civile në shërbim të demokracisë lokale", financuar nga Bashkimi Evropian përmes Programit IPA për shoqëri civile dhe media dhe të zbatuar nga: Asociacioni Evropian për Demokraci Lokale (ALDA) Shkup, Shoqata e punonjësve financiarë të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike (SHPF) dhe Lëvizjes Evropiane (LE).

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Shoqatës së punonjësve financiarë të vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjeve publike (SHPF), Asociacionit Evropian për Demokraci Lokale (ALDA) - Shkup dhe Lëvizjes Evropiane (LE) dhe jo gjithmonë i reflekton pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.